

Revistë periodike, satirike, sociale e kulturore
Viti II / Nr.11 / Dhjetor 2025

Çmimi: 5 €

HITHI ESH

"ËSHTË MË MIRË TË JESH NJË HAJDUT I MIRËNJOHUR,
SE SA NJË I NDERSHËM E I INJORUAR NGA TË GJITHË".
UMBERTO ECO

HËRCEN BORËBARDHI NGA GËZIMI SË BASHKU
ME FËMIJËT E PLEOTË, QË MORI EDHE AI 100
EURO PËR VITIN E RI!



Botues: Shoqata e Karikaturistëve HiTHi
Kosova Cartoon

Drejtör: Imri Musliu

Koordinator: Besnik Rustemi

Redaksia: Skender Demolli, Abdyl
Hajredini, Sulejman Dërmaku, Imri Musliu

Përkthyes: Fadil Bajraj

Dizajni grafik i kopertinës: Fleta Baraku

Adresa: Rr. Ramadan Rexhepi, 70000
Ferizaj

Republika e Kosovës

Telefoni: +38344224586

Email: hithi.kosova@gmail.com

* * *

Në këtë numër mund të lexoni:

Festa mbarëkombëtare e 28 Nëntorit 2025
presidentja osmani pret mërgimtarët

Juritë e dobëta e dëmtojnë artin e karikaturës
Karikatura: dritë apo thikë?

Seriozisht për të qeshurën
Punëtorja HiTHi

Me HiTHi n'dorë

Aforizma

Poezi satirike

Karikatura

Fabula

Anekdota

Opinione për libra

PRESIDENTIA E REPUBLIKËS VJOSA
OSMANI URON BASHKËKOMBËSIT E SAJ
TË ARDHUR NGA EMIGRACIONI PËR TË
FESTUAR NË ATDHE



Presidentja Vjosa Osmani në një takim të ngrohtë e miqësor një ditë pas Krishtlindjeve në Prishtinë mes bashkëkombasve të saj të ardhur nga diaspora për të festuar në atdhe Festat e fundvitit, i uron ata dhe gjithë të tjerët përmes tyre kudo ku punojnë e jetojnë për një vit të mbarë e lumturi në familje. Gjatë takimit nuk kanë munguar edhe shakatë e humori që e bënë edhe më të përzemërt pritjen si dhe dhuratat simbolike – një portret kushtuar presidentes nga një piktor në emigracion, por edhe librat më të fundit të poetëve satirikë Faruk Tasholli, Musa Ahmetaj me vargjet e tyre shpotitëse për politikanët, të cilët u vlerësuan para pak ditësh me Çmime në Festivalin Mbarëkombëtar të letërsisë së humorit e satirës “Niko Nikolla”, që u mbajt në Korçë nga data 13 – 15 dhjetor 2025.

Karikatura për Vitin e Ri 2026



Agron Sejdiu, Kosovë



Imri Musliu, Kosovë



Ilia Makris, Greqi



Angel Boligan, Meksikë



Serpil Kar, Turqi



Karikatura: Endri Beqo, Shqipëri

Vetëvendosje fiton zgjedhjet në Kosovë, PDK forcë e dytë, LDK e treta

Lëvizja Vetëvendosje ka shënuar fitore të thellë në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit.

Ndërsa janë numëruar mbi 97% të votave, LVV ka marrë 49,72% të votave.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka publikuar rezultatet në faqen zyrtare;

LVV ka marrë 49,72% të votave, PDK 21,19%, LDK 13,74 % dhe AAK 5,74%.


Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AAK ka marrë në këto zgjedhje 5,73 % ose 48, 630 vota.

Ndërsa Lista Srpska ka marrë sipas KQZ 3,86 %. Partia Nisma Socialdemokrate ka marrë 1,71 % ose 14, 545 vota.

Në Kosovë u mbajtën zgjedhjet e parakohshme parlamentare, ku të drejtë vote kishin 1.999.024 qytetarë.

Procesi i votimit u zhvillua në 910 qendra me gjithsej 2.557 vendvotime, nga ora 07:00 deri në 19:00.

Sipas të dhënave nga KQZ në Kosovë, pjesëmarrja në zgjedhje është 45 për qind.



FESTA MBARËKOMBËTARE E 28

Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti ka uruar të gjithë shqiptarët për festën e Flamurit. Në një postim në Facebook, Kurti vuri në dukje se nuk duhet të ketë një tjetër komb në botë që fati i tij të jetë ndërthurur kaq pazgjidhshmërisht me një datë të caktuar ashtu siç gërshetohet data 28 Nëntor me fatin e kombit tonë. "Kjo ditë e 28-të e muajit të njëmbëdhjetë vërtet ishte një aksident historik i vitit 1443, por një aksident i këtillë, i përsëritur me kaq ngulm përgjatë historisë, doemos u kthye dhe u bë një shenjë e shenjtë e kalendarit tonë kombëtar", thotë ai. Mes tjerash, ai ka shkruar se në këtë datë, mbi Kështjellën e Krujës, u ngrit flamuri kuq e zi i Kastriotëve, që u kthye dhe u bë edhe flamur yni kombëtar. "Kështu nisi rrugëtimi i nëntorëve tanë që erdhën e u lidhën si hallka të një zinxhiri të pashkëputshëm, duke shënuar jo vetëm data kalendarit, por edhe rrugën e lirisë sonë. Pas shumë shekujsh, më 28 nëntor 1912, ky flamur u ngrit prapë në Vlorën e Labërisë, kur u shpall mëvetësia e Shqipërisë së sotme Administrative. Ky ishte Nëntori ynë i Dytë. Në këtë shpallje u njëmëndësua një pjesë e projektit largpamës të Sami Frashërit, i cili kishte paraparë një Shqipëri në kufijtë e përafërt të katër vilajeteve. Ai theksonte qartë që "qëllimi i vetëm i shqiptarëve është të ruajnë Shqipërinë të mos copëtohet prej të huajve, të mbajnë gjuhën e kombësinë e tyre". Por kjo, për fat të keq, në atë kohë u arrit vetëm pjesërisht, thotë ai.

Kurti thekson se "Për më tepër, në kujtimet e tij, në përvjetorin e parë të pavarësisë, në vitin 1913, Luigj Gurakuqi shprehej se "në jetën e kombevet, si edhe në jetën e njerëzve ndodhin hera-herë disa rasa të paprituna, që trazojnë rrjedhën e punëve dhe shkaktojnë disa ngjarje, që as nuk pritej, as nuk shpresohet të ndodhnin". "Ashtu kishte ngjarë në vitin 1912, mot i mbushur me mjerime e me pësime, por që, në mes të

trazimeve e të ligave të panjohura, kishte sjellë edhe një send të pashpresuar e të paçmueshëm, dmth. lirinë, bashkimin dhe pavarësinë e Atdheut! "Megjithëkëto, historia e nëntorëve tanë nuk mbaron këtu". " Në po këtë datë, në vitin 1955, në kullat e Jasharëve në Prekaz lindi Kryekomandanti i UÇK-së, Adem Jashari, njeriu që do të vihej në ballë të luftës për lirinë e Kosovës. Po ashtu, më 28 nëntor të vitit 1997, UÇK-ja, për herë të parë, doli publikisht për t'ia bërë me dije botës se ky popull ishte i gatshëm të bënte çdo flijim dhe nuk do të hiqte dorë kurrë nga lufta për liri"- theksoi Kurti. Kurti ka pohuar se gjithë këto përpjekje, luftëra e flijime të atdhetarëve shqiptarë nëpër shekuj janë kurorëzuar sot me Shqipërinë e pavarur dhe me Kosovën e pavarur. "Natyrisht, si komb evropian, sytë i kemi të kthyer kah e ardhmja, kah një Nëntor i Tretë, që duhet të vijë nëpërmjet përpjekjeve tona, punës dhe përkushtimit tonë të vazhdueshëm. Ky Nëntor i Tretë, edhe nëse nuk do të bjerë në këtë ditë, edhe nëse nuk do të jetë muaj i nëntorit, ne mund ta pagëzojmë që sot si 28 Nëntori ynë i Tretë. Atëherë amaneti i të gjithë atdhetarëve shqiptarë, të gjallë e të vdekur, do të përmbushet. Urojmë që kjo ditë të vijë sa më shpejt". "Vëllezër shqiptarë e motra shqiptare, kudo që gjendeni, mes familjeve e miqve tuaj, në këtë ditë gëzimi e feste: Gëzofshi 28 Nëntorin, Ditën e Flamurit".



JURITË E DOBËTA E DËMTOJNË ARTIN E KARIKATURËS

gjykojnë nëpër festivalet e ndryshme nëpër botë, e që shpesh lënë për të dëshiruar, ose për shkak se janë të njëanshëm ose që nuk i përcjellin festivalet në mënyrë të vazhdueshme dhe nuk e njohin mirë trendin e karikaturës në botë, se edhe karikatura evoluon, ashtu si edhe gjithçka tjetër. Kanë shkruar shumë e shumë karikaturistë, shumica në revistën Cartoon Magazine e cila del çdo të premte në Iran dhe këtu po e paraqes reagimin e karikaturist iranien, njëherit edhe redaktor i Cartoon Magazine, z. **Abbas Naaseri**, në lidhje me këtë temë.

Shkrimi i një ilustruesi iranien:

“Nëse operon si karikaturist në vendin apo qytetin tënd dhe ke shumë njerëz apo autoritete lokale që të njohin, kjo nuk do të thotë që duhet të organizosh një festival, pa ekspertizën dhe infrastrukturën e nevojshme dhe të kontribuosh në çrregullimin që mbizotëron në evenimente të tilla.”

Kur një karikaturist që nuk ka eksperiencë dhe njohuri të mjaftueshme në organizimin e një festivali, nuk konsultohet e as nuk është bashkëpunues, shkakton probleme me të

Kohëve të fundit ka filluar të flitet më shumë për juritë që

cilat ballafaqohemi sot, duke dëmtuar si artin ashtu edhe artistët.

Një sekretar i pakualifikuar zgjedh emocionalisht jurinë.

Shpesh themi: Të jesh karikaturist dhe të jesh anëtar jurie, janë dy gjëra krejtësisht të ndryshme; Kjo kërkon një grumbullim të jashtëzakonshëm informacionesh që kërkon përditësime, studim dhe ndjekje të vazhdueshme. Vetëm pse dikush dikur ishte karikaturist i mirë, nuk ka prodhuar vepra të reja për vite me radhë dhe ka qëndruar larg trendeve bashkëkohore ndërkombëtare, nuk do të thotë që sot duhet të jetë në juri në ndonjërin nga festivalet e karikaturës.

Respektimi i veteranëve është i rëndësishëm në vetvete, por në çështje si këto, gjërat ndryshojnë. Besoj se secili veteran që do të vlerësojë artefaktet bashkëkohore duhet të ndjekë edhe karikaturat e sotme. Një i moshuar që nuk e ka përditësuar veten dhe ka ngecur në të kaluarën, nuk do t'i shërbejë qëllimit për të qenë anëtar jurie, kur thotë: "Mjafton të gjykos; kontrollimi i ngjashmërive në mënyrë të përsëritur nuk

është i përshtatshëm për moshën time;
mjafton shikimi i parë për t'i nxjerrë
rezultatet "

E ju, ngaqë ju mungon ekspertiza
organizative, krijoni juri të dobëta që as
prania e një anëtari të fortë nuk mund ta
ndryshojë rezultatin.

Ju nuk i vini re ngjashmëritë; ju vendosni
rregulla që nuk mund t'i zbatoni. Kur ju
tregohen këto ngjashmëri dhe rregulla, ju i
inJORONI tjerët, për t'i mbajtur miqtë dhe
bashkëpunëtorët tuaj mes fituesve.

Me dashje apo pa dashje, ju e dëmtoni artin
e karikaturës, duke bërë foto për veten tuaj
dhe duke ngritur statusin tuaj social në
qytetin dhe vendin tuaj, pa e menduar se
prestigji i karikaturës po zvogëlohet. Kjo
nuk është asgjë e re; ka kohë që është
përhapur në shumë vende gjatë dekadës së
fundit. Ashtu si të veshësh pantallona të
shkurtra futbolli dhe të kesh një foto me to,
nuk të bën të dukesh si Maradona. Të jesh
karikaturist, nuk të kualifikon automatikisht
për të menaxhuar një ngjarje.

Ekspertiza, përvoja, infrastruktura, dija,
përkatësia dhe ndershmëria, janë cilësi
thelbësore për një drejtor festivali; ato janë
cilësi që nuk i shohim tek një pjesë e
madhe.

Ju lutem, tani e tutje, kushtojani kohën dhe
energjinë tuaj karikaturës, nxënësve tuaj që
besojnë tek ju si mësues, dhe autoriteteve në
qytetin apo vendin tuaj që ju nderojnë.

Krijoni hapësirë për të kualifikuarit dhe
ekspertët e vërtetë".

E marr këtu edhe komentin e karikaturistit
Javad Takjoo, si më poshtë....

Duke iu referuar pikëpamjeve të shprehura
nga z. Naaseri, dua të ndaj disa pika bazuar
në përvojat e mia personale dhe vëzhgimet
direkte në festivale dhe konkurse të
ndryshme ndërkombëtare të karikaturës.

Kam marrë pjesë në shumë ngjarje
ndërkombëtare gjatë viteve të fundit dhe
kam parë se si disa festivale që dikur kishin
prestigj të vërtetë, fatkeqësisht, janë kthyer
në ceremoni private, të mbyllura; lidhjet
personale dhe vendimet e paracaktuara kanë
lënë anash transparencën, drejtësinë dhe
profesionalizmin.

Personalisht kam qenë dëshmitar i proceseve
të çuditshme dhe iracionale të vlerësimit, ku
shpërfillen veprat origjinale, dhe veprat
fituese janë kopje të hapura ose imitime të
veprave të njohura të artit. Këta anëtarë të
jurive të paafta dhe të painformuara, nuk
ishin në gjendje të njihnin probleme të tilla

dhe madje as nuk i pranonin gabimet e tyre kur u tërhiqej vërejtja.

Ajo që është më zhgënjyese, ka festivale që i shpërblejnë veprat sipërfaqësore, të dobëta dhe tërësisht amatoreske, që nuk kanë të bëjnë fare me standardet profesionale të artit në aspektin e aplikimit, konceptit dhe teknikës. Zgjedhje të tilla, jo vetëm që e dëmtojnë besueshmërinë e konkurrencës, por e dëmtojnë drejtpërsëdrejti nderin dhe integritetin e artit të karikaturës.

Në festivalet e pakta ku juria zhvillohet me përpikmëri, transparencë dhe përgjegjësi, shihet qartë se si profesionalizmi natyrshëm ndërton besimin dhe respektin. Fatkeqësisht, shembuj të tillë janë të rrallë, dhe shumica e festivaleve sot kanë rënë në kurthin e fanatizmit dhe paragjykit personal.


Një çështje tjetër shqetësuese që e kam vërejtur, është edhe paaftësia e shumë jurive për të bërë dallimin midis veprave të vërteta të artit digjital dhe atyre të krijuara me inteligjencë artificiale. Disa anëtarëve të jurive të cilëve u mungojnë edhe njohuritë themelore të treguesve vizualë dhe modeleve të krijuara nga intelijenca artificiale, mashtrohen lehtësisht nga tërheqja sipërfaqësore e këtyre imazheve

dhe, çuditërisht, madje mund të vlerësohen. Kjo injorancë përbën një kërcënim serioz për krijimtarinë origjinale dhe vetë thelbin e integritetit artistik në karikaturë.

Arti vizatimor është një gjuhë e gjallë e mendimit dhe e shoqërisë. Injorimi i ndryshimit, inovacionit dhe perspektivave të reja nuk do të thotë ruajtja e traditës, por është një hap prapa. Respektimi i artistëve me përvojë është i rëndësishëm, por pjesëmarrja në një juri kërkon ndërgjegjësim, mësim të vazhdueshëm dhe një kuptim të përditësuar të mjeteve dhe teknikave moderne.

Si artist që kam vëzhguar dhe bashkëbiseduar nga afër me juritë, artistët dhe festivalet në vitet e fundit, besoj se e vetmja mënyrë për ta ruajtur besueshmërinë e artit të karikaturës është përmes ndershmërisë, dijes dhe transparencës në vlerësim.

Pa këto tre elemente, asnjë festival, pavarësisht se sa është i madh emri i tij - nuk mund ta ruaj integritetin ose ta siguroj të ardhmen e tij.



Karikatura: dritë apo thikë?

Qeshja që shëron, qeshja që lëndon

Karikatura zakonisht kuptohet si vizatim me tipare të ekzagjeruara (fytyrë, trup, gjeste), shpesh me dozë humori. Pikërisht këtu lind dilema: a e ushqen karikatura bullizmin (sepse thekson “asimetrinë”, “të metat”, “çuditshmërinë”), apo mund të shërbejë si mjet pozitiv për shëndetin mendor?

Në fakt, karikatura ka prirje të ketë ndikim pozitiv në shëndetin mendor kur përdoret si aktivitet i strukturuar, krijues dhe i sigurt (sidomos si vetë-karikaturë ose karikaturë e personazheve fiktive), sepse aktivizon mekanizma të art-terapisë dhe të humorit: ul stresin, rrit vetëpranimin, rrit lidhjen sociale dhe fleksibilitetin kognitiv. Por, kur përdoret si “etiketim” i tjetrit ose si mjet talljeje, rrit rrezikun e turpit, stigmatizimit dhe bullizmit.

Karikatura është një “mjet me dy tehe”. E njëjta teknikë, si ekzagjerimi vizual, mund të të stresit, por efektet varen fort nga korniza etike, qëllimi dhe mënyra e përdorimit.

Ka prova se ndërhyrjet me të qeshurën/komedinë lidhen me përmirësime në mirëqenie dhe me mekanizma si lidhja sociale, shpresa, identiteti dhe fuqizimi (Kafle et al., 2023). Edhe në nivel fiziologjik, një meta-analizë e studimeve ndërhyrëse gjeti se të qeshurat spontane shoqërohen me ulje të kortizolit (hormonit të stresit) (Kramer & Leita, 2023).

Te fëmijët, është treguar se vizatimi për të shpërqendruar veten (jo domosdoshmërisht për ta shprehur drejtpërdrejt trishtimin) mund ta



prodhojë çlirim emocional, humor, distancim nga stresi, por edhe turpërim, stigmatizim dhe bullizëm, sidomos kur “godet poshtë” (te më i dobëti), kur normalizon përqeshjen e trupit, gjinisë, varfërisë, aftësisë së kufizuar apo prejardhjes.

Literatura shkencore tregon se aktivitetet artistike aktive (p.sh. vizatim, skicë, krijim) dhe ndërhyrjet me humor/komedi mund të lidhen me përmirësime në mirëqenie dhe me reduktim

përmirësorë humorin, sepse rrit përthithjen/absorbimin, kënaqësinë dhe ndjenjën e kompetencës (Drake, 2021). Në praktikë, karikatura shpesh e bën pikërisht këtë: i fut pjesëmarrësit në një “lojë serioze”, ku mendja zhvendoset nga ngarkesa emocionale te kreativiteti.

Karikatura ka potencial të rrisë mirëqenien psikologjike kur përdoret si art aktiv dhe humor prosocial (që ndërton lidhje), sepse nxit shpërqendrim të shëndetshëm, rrit ndjenjën e kompetencës dhe krijon lidhje sociale. Por, pa kornizë etike, karikatura mund të rrisë

stigmatizimin dhe bullizmin, duke normalizuar humoren agresiv dhe përqeshjen e “të dobët”.

Ka një studim të rëndësishëm që lidhet drejtpërdrejt me tezën tonë: në një ndërhyrje me adoleshentë të shtruar në spital për rrezik vetëvrasjeje, pjesëmarrësve iu kërkua të rishikonin pritjet e tyre për të ardhmen, duke krijuar një karikaturë të vetes në të ardhmen (Walsh & Minor-Schork, 1997). Në intervistat pasuese, adoleshentët e përshkruan këtë proces si një kërkim identitar me element humor, i cili ringjalli ëndrrat dhe forcoi ndjenjën e kontrollit mbi të ardhmen (Walsh & Minor-Schork, 1997). Kjo nuk është provë se karikatura “parandalon vetëvrasjen”, por është provë se karikatura, si mjet, mund të aktivizojë shpresën dhe ndërtimin e identitetit, dy shtylla kyçe në punën klinike me rrezik vetëvrasjeje (Walsh & Minor-Schork, 1997; Walsh, 1993).

Tash duhet t’i rikthehemi një teme shumë aktuale në shoqërinë tonë kosovare, të cilën shpesh e hasim në kryetitujt e portaleve elektronike dhe në rrjetet sociale, por do të kalojmë përmes një studimi se si ka arritur art-terapia ta ulë bullizmin.

Bullizmi në shkollë nuk është “ngacmim i zakonshëm”, por një model i përsëritur dëmtimi (verbal, fizik ose relacional, p.sh. përjashtim, poshtërim, izolim), zakonisht i shoqëruar me pabarazi fuqie, dhe për këtë arsye konsiderohet fenomen me peshë të madhe shëndetësore e shoqërore: ai prek jo vetëm viktimën, por klimën e gjithë shkollës dhe lidhet me pasojë emocionale, sociale dhe akademike (UNESCO, 2019; World Health Organization Regional Office for Europe, 2024). Pikërisht në këtë kontekst bëhet shumë i vlefshëm studimi ndërhyrës i Yan, Chen dhe Huang (2019) në shkolla rurale me “left-behind children” (fëmijë që jetojnë të ndarë nga prindërit për periudha të gjata për shkak të migrimit të tyre për punë), sepse ky grup ka rrezik më të lartë për viktimizim, ankth social dhe dobësim të lidhjes me shkollën; autorët fillimisht përfshinë 603 fëmijë nga gjashtë shkolla (272 LBC dhe 331

jo-LBC) dhe gjetën se LBC raportonin më shumë viktimizim nga bullizmi, me ndjeshmëri të shtuar të djemtë dhe të disa nën-grupe moshore/familjare (Yan et al., 2019). Më pas, për të testuar nëse një ndërhyrje kreative mund të ndikojë realisht, studimi përzgjedhi 180 fëmijë LBC me nivelet më të larta të viktimizimit dhe i sistemoi në mënyrë të rastësishme në tre grupe (art-terapi, këshillim i përgjithshëm dhe kontroll), me gjashtë seanca përgjatë tre muajve; rezultati kryesor ishte se art-terapia u shoqërua me ulje të viktimizimit nga bullizmi dhe rritje të vetëvlerësimit pas ndërhyrjes, ndërsa këshillimi i përgjithshëm nuk dha të njëjtin efekt në bullizim (Yan et al., 2019). Ky studim sugjeron se arti i strukturuar (vizatim/punë vizuale) mund të funksionojë si mjet ndërhyrës në një problem social “të madh”, sepse ofron një mënyrë më të përballueshme për shprehje dhe përpunim të përvojave (sidomos kur të folurit drejtpërdrejt është i rëndë ose i përehatshëm), ndërton ndjenjë kompetence dhe agjencie (“unë krijoj kuptim”) dhe mund të forcojë vetëvlerësimin, një faktor mbrojtës i njohur kundër izolimit dhe viktimizimit (UNESCO, 2019; Yan et al., 2019). Në këtë logjikë, karikatura, kur drejtohet me rregulla etike (p.sh. “punch up”, jo tallje me të pambrojturit), mund të përfitojë nga të njëjtët mekanizma: të kthejë frikën/ankthin në “personazh” që mund të trajtohet, të krijojë distancë nga turpi dhe të hapë dialog social pa e normalizuar poshtërimin (World Health Organization Regional Office for Europe, 2024; Yan et al., 2019).

Në fund, pyetja nuk është nëse karikatura është “e mirë” apo “e keqe”, por si e vendosim ne në shërbim të shëndetit mendor dhe të dinjitetit njerëzor. Kur ajo përdoret me etikë, kur “godet lart” dhe jo poshtë, karikatura bëhet një gjuhë që çliron: i jep formë ankthit, e bën të përballueshëm turpin, e kthen zemërimin në reflektim dhe e shndërron heshtjen në dialog. Karikatura nuk është vetëm një vizatim me hundë të madhe apo me vijë të shtrembër; është një mënyrë si ne e shohim njeriun dhe si e

lexojmë shoqërinë. Ajo mund të jetë dritë kur e përdorim për ta çarmatosur frikën, për ta shndërruar stresin në diçka të përballueshme dhe për t'i dhënë zë atyre që zakonisht heshtin. Mund të jetë edhe thikë kur e përdorim për ta ulur dikë, për ta kthyer “të ndryshmin” në objekt qeshjeje dhe për ta normalizuar poshtërimin. Prandaj, fuqia e saj qëndron te zgjedhja: a po e përdorim humorin për të ndërtuar vetëdije dhe empati, apo për të prodhuar turp? Kur karikatura ruan dinjitetin e njeriut dhe e godet problemin, jo viktimën, ajo bëhet më shumë se art: bëhet një formë kujdesi publik, një mënyrë e mençur për të folur për dhimbjen pa e rritur atë dhe një ftesë për të qeshur bashkë pa e lënë askënd vetëm.

“Kush e paguan çmimin e kësaj qeshjeje?”

Që lexuesi ta kuptojë qartë kufirin, mjafton një pyetje e thjeshtë: kush po paguan çmimin e kësaj qeshjeje? Nëse qeshja ndërtohet mbi një njeri të pambrojtur, mbi një fëmijë, mbi dikë që s'ka fuqi t'i kthejë përgjigje, atëherë nuk është satirë, është riprodhim i bullizmit me mjete artistike. Ndërsa, kur karikatura i drejtohet sjelljes, rolit, padrejtësisë, hipokrizisë, mekanizmave të pushtetit ose absurditeteve të përditshme, ajo bëhet një formë e mençur “shkarkimi”: e ul agresionin, e rrit vetëdijen dhe e bën shoqërinë të shohë veten pa u mbrojtur me gënjeshtër.

Po aq e rëndësishme është edhe mënyra si krijohet karikatura, sidomos kur bëhet në shkollë, kurs ose punëtori. Kur ka rregulla të qarta (p.sh. “qeshim me situatën, jo me personin”, “kritikojmë sjelljen, jo trupin”, “askush s'vizatohet pa dëshirë”), karikatura mund të shndërrohet në një ushtrim që rrit sigurinë: njerëzit mësojnë të shprehin emocione, të flasin për ankthin përmes personazheve, të distancohen nga mendimet e rënda dhe të krijojnë lidhje me të tjerët, pa frikë nga gjykimi.

Drake, J. E. (2021). How drawing to distract improves mood in children. *Frontiers in Psychology*, 12, 622927. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2021.622927>

Kafle, E., Papastavrou Brooks, C., Chawner, D., Foye, U., Declercq, D., & Brooks, H. (2023). Beyond laughter: A systematic review to understand how interventions utilise comedy for individuals experiencing mental health problems. *Frontiers in Psychology*, 14, 1161703. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2023.1161703>

Kramer, C. K., & Leita, C. B. (2023). Laughter as medicine: A systematic review and meta-analysis of interventional studies evaluating the impact of spontaneous laughter on cortisol levels. *PLOS ONE*, 18(5), e0286260. <https://doi.org/10.1371/journal.pone.0286260>

UNESCO. (2019). Behind the numbers: Ending school violence and bullying. UNESCO.

Walsh, S. M. (1993). Future images: An art intervention with suicidal adolescents. *Applied Nursing Research*, 6(3), 111–118. [https://doi.org/10.1016/S0897-1897\(05\)80171-5](https://doi.org/10.1016/S0897-1897(05)80171-5)

Walsh, S. M., & Minor-Schork, D. (1997). Suicidal adolescent perceptions after an art future image intervention. *Applied Nursing Research*, 10(1), 19–26. [https://doi.org/10.1016/S0897-1897\(97\)80045-6](https://doi.org/10.1016/S0897-1897(97)80045-6)

World Health Organization Regional Office for Europe. (2024). Health Behaviour in School-aged Children (HBSC) study: International report 2021/2022 (Highlights on bullying and cyberbullying). WHO Regional Office for Europe.

Yan, H., Chen, J., & Huang, J. (2019). School bullying among left-behind children: The efficacy of art therapy on reducing bullying victimization. *Frontiers in Psychiatry*, 10, 40. <https://doi.org/10.3389/fpsyg.2019.00040>

SERIOZISHT PËR TË QESHURËN




[Marrë nga libri i Bujar Kapexhiut
“VARIACIONE” (Karikatura 1962 –
1990, Tiranë 2022)]

- Përsose karakterin tënd duke qeshur me veten.
- Me shakanë e eprorit, servili qesh edhe kur ai mungon.
- E qeshura gabim sjell zemërim.
- Kur ke mundësi të qeshësh, gabon që rri serioz.
- E qeshura pa shkak të bën qesharak.
- Mos qesh kur nuk kupton, se qeshin të tjerët me ty.
- E qeshura false, tamam si masturbim.
- Serioziteti me cak, që të mos bëhesh qesharak.

- Harro të krihesh e jo të qeshësh. Krehja të hijeshon, e qeshura të zbukuron.
- Mos u inatos me të qeshurën e tjetrit, por qesh me inatin tend.
- Mos u mburr që je serioz, por merakosu që nuk di të qeshësh.
- E qeshura në vetmi, si vera në fuçi. E qeshura me shokë, si vera në gotë.
- Nuk është aspak e bukur kur qesh për t’u dukur.
- Të qeshësh me një budallallëk është marrëzi. Të qëndrosh serioz është mençuri.
- Kur me urdhër qesh, veten e përqesh.
- Kur të qeshurën e vonon, kënaqësinë e shpirtit e mënjanon.
- Kur harron të qeshësh, ke harruar të jetosh.
- Nuk inatosem kur me mua qeshin. Zemërohem kur më përqeshin.
- Je qesharak kur e tepron me seriozitet dhe je serioz kur qesh sa duhet, ku duhet e kur duhet.
- Je qesharak si njeri, kur seriozitetin e ke me tepri.
- Kur ke punë qesh më shumë; kur s’ke punë, të vjen gjumë.

- Kur e mendon politikën, e qeshura të ikën.
- Dhuro një buzëqeshje fytyrës së brengosur, trishtimin për t'ia sosur.
- Sa herë buzëqeshje dhuron, del faqebardhë dhe fiton.
- Kur je i buzëqeshur dhe i ditur, je kurdo i mirëpritur.
- Fytyra e qeshur e qetëson turmën, fytyra e ngrysur e shton zhurmën.
- Të vetmuarit e në rrezik, buzëqeshja i shton një mik.
- Heshtja të largon, buzëqeshja të afron.
- E qeshura është serioziteti i artit komik.
- Buzëqeshja dhe përçmimi, të lidhur, bëhen më fytes e më të hidhur.
- Me buzëqeshjen, edhe pse e jep falas, del i fituar.
- Buzëqeshjen e vërtetë mos e shih te buzët por te sytë.
- Në buzëqeshjen për të tjerët, ke edhe ti pjesën tënde.
- Buzëqeshja është prona jote që u shërben të tjerëve.
- Nëse tjetri të pyet pse qesh, tregon se ke gabuar.



Përzgjedhi: I. Musliu



FESTIVALI MBARËKOMBËTAR I SATIRËS DHE HUMORIT “NIKO NIKOLLA” Humorous literature unites authors in Korça/The nationwide "Niko Nikolla" competition begins Nationwide Humorous Literature Competition "Niko Nikolla" has begun in the city of Korça, a cultural event that aims to promote and raise the level of Albanian humorous literature. This edition features 31 authors, mainly from Albania, but also from Kosovo, Presheva, Serbia, Germany and Italy, in genres such as prose, poetry, comedy and satire. The activity was also accompanied by a mini-book fair, where the authors presented their works. The organizer of the event, Flora Nikolla, stated that this activity represents a special journey for authors and humor lovers, turning Korça into a meeting point for writers of this genre. According to her, the main goal of the competition is to create a map of Albanian authors who cultivate humor literature, as well as to evaluate the work and sacrifices they make until the publication of their works. Humorous literature unites authors in Korça/The nationwide "Niko "It is a long and short journey of the third nationwide humorous literature competition. We are pleased to bring it to the wonderful city of Korcë. The main goal of

organizing this event is to raise the level of humorous literature to a higher level. We wanted to create a map of Albanian writers of this type of literature. 31 authors participate in this competition, most of them from Albania, in the genres of prose, poetry, and many comedies. There are participants from



Presheva, Kosovo, Germany, Italy, so we tried to create a map of this literature. We also have a mini-fair where the authors brought their works so that they feel appreciated because of the great sacrifices they make until their publication, with passion and perseverance, continuing the tradition of humor," said Nikolla. Humorous literature unites authors in Korça/The nationwide "Niko Also participating in the competition was Bujar Kapexhiu, the well-known artist, who presented his book "Poetry, Humor, and Satire". He emphasized that humor is one of the most difficult genres of art, but at the same time the most favorite by the public, as it conveys messages and addresses social issues through a smile. "It is a pleasure for me to be in Korçë today. A humor festival is being organized for literature, prose, fable, poetry. Humor is the most difficult genre of art, so looking at this stand with books, you are pleased because it is produced. There are people who

deal with humor, who write, who think about humor and satire, and to give readers not only a smile but through their writings they also give them the message, the problematic that they attack, stigmatize. The art of humor is preferred on stage, in art, in literature, and we who deal with humor have the pleasure that the spectators at least smile when they receive our works", said Kapexhiu. Humorous literature unites authors in Korça/The nationwide "Niko The event also included visual arts, with the participation of cartoonist Endri Beqo, who brought works on social and current topics. In his cartoons, he addressed the lack of peace and human suffering caused by conflicts in the world, reflecting reality through the art of humor and satire. "I am from Tirana and I graduated in figurative arts, I develop cartoons with social themes and express my energy in current issues in the world. Art is really fading, but I am dealing with art and I am trying to walk this path. Today in my cartoons I have brought a world that is crying because there is no peace. You see for yourself that there is war in Ukraine, Palestine, and I have expressed something about the suffering and the bitter truth that is being shown," said Beqo. Humorous literature unites authors in Korça/The nationwide "Niko The third nationwide competition of humorous literature "Niko Nikolla", which is taking place at the "Andon Zako Çajupi" Theater in Korça, will last until the 15th, gathering authors from the Albanian regions and the diaspora. The activity will close with the award ceremony on the last day, where the most outstanding creations in prose, poetry, comedy and satire will be evaluated, confirming the importance of humor as a form of art and social reflection./CNA



E QESHURA E ZBUKURON NJERIUN – SIDOMOS NE VAJZAVE DHE GRAVE.
A THUA PËR KËTË FLORA NIKOLLA ËSHTË PRESIDENTE E NJË FESTIVALI TË
TILLË?

(Mbresa nga Konkursi Mbarëkombëtar i letërsisë satirike – humoristike “Niko Nikolla”, në edicionin e tij të tretë - Korçë dhjetor 2025)

Nga Artiola KONDAKÇI

U ndjeva e privilegjuar që u gjenda për herë të parë në një konkurs humori, pikërisht unë, që më shumë kam shkruar për dhimbjen, sesa të qeshurën. Por humori, ashtu si dhimbja e tragjizmi, që e ka në thelb është një formë e thellë e së vërtetës njerëzore, ja pse te Konkursi i tretë Mbarëkombëtar i Letërsisë së Humorit “Niko Nikolla”, zhvilluar në 13-15 dhjetor 2025 në Korçë, mes buzëqeshjeve, emocioneve dhe fuqisë së fjalës përfaqësova librin “Shkrimet e një jete”, të vëllait tim Ardian Kondakçiu, të cilin ia kam botuar 20-të vjet pas largimit të tij të parakohshëm nga kjo botë, në moshën 32- vjeçare gjatë punës në emigracion, në Athinë. Përzgjedhja e krjimeve nga fletoret e vjetëruara e me shkrim dore prej tij, për të arritur te procesi i korrektimit, redaktimit dhe imazhit estetik për një botim dinjitoz, nuk ka qenë e lehtë për mua, sepse në të gjitha fazat më duhet të hyja në botën e autorit, për të qenë sa më afër origjinalitetit. Dhe kur gjithçka është realizuar si një “amanet i pashkruar”, ndjeva lehtësim për këtë synim përmbushës, por ndërkohë që për disa arsye nuk arrita t’i bëja vjet një promovim librit në Athinë, aty ku ai humbi jetën dhe kishte patur pjesën më të madhe të krijimtarisë me temë emigracionin përgjatë viteve 1993-2003, njoftimi për Konkursin mbarëkombëtar të humorit “Niko Nikolla” u bë një shtysë, që atë libër ta çoja në garë për konkurim, meqenëse njëra prej katër pjesëve në brendësi sjell plot humor edhe çaste komike nga jeta dhe bëmat e emigrantëve shqiptarë.



Në shkrimet e Kondakçiut humori nuk ishte arrati nga realiteti, por mënyrë për ta përballuar atë. Ndjesitë humoristike të lindura nga emigracioni më përfshinë edhe mua që nuk e kam provuar mërgimin, sepse pata njohje nëpërmjet librit me një pjesë të historisë së mërgimtarëve, e cila nuk mbetet thjesht personale, por përgjithësohet sipas këndvështrimit altruist me syrin e komikut, ku e qeshura dhe humori burojnë nga tragjizmi i një jete dhe kohe të vështirë që u ra në hise pas rënies së komunizmit në Shqipëri e largimit nga vendi të mijëra shqiptarëve për një jetë më të mirë, humor si një terapi për të sfiduar vështirësitë e fillimit dhe të panjohurën bashkë me dukuri të racizmit, shfrytëzimit informal të krahut të punës, pabarazisë sociale e deri në shkeljen e të drejtave të njeriut si qytetarë të kategorisë së dytë me telendisjen për vite të tëra në kalvar burokratik për të gjetur veten dhe për tu integruar në një shoqëri e vend të BE – së. Në skicat e tregimet e librit përpos satirës dhe ironisë vihet re edhe pohimi i së mirës veç mohimit të së keqes me një gjuhë të pasur e të gjallë e cila shpesh ngjan me atë “të rrugës” por larg vullgares, gjë që e bën librin të besueshëm dhe pasuron vlerat e tij aristike.

Emrin e shkrimtarit tonë të humorit Niko Nikolla që mban ky Konkurs Mbarëkombëtar i letërsisë në këtë gjini e njihja nga revista e dikurshme “Hosteni”, si Kryeredaktor i saj për më shumë se dy dekada dhe si një medie nga më populloret të shekullit që lamë pas, për faktin se vëllai im ishte abonuar dhe përpinte me sy që i qeshnin, dhe shumë numra të kësaj reviste egzistojnë ende të ruajtura koleksion në bibliotekën tonë të larmishme. Prandaj, mirënjohja ime u bë edhe më e thellë, kur pashë se vajza e tij gazetarja e redaktorja e njohur e Agjencisë Telegrafike Shqiptare, znj. Flora Nikolla kishte marrë mbi vete misionin për ta çuar më tej misionin e babait të vet për zhvillimin e satirës dhe humorit shqiptar si dhe veprën e tij, duke e bërë emrin e tij emblema të kësaj veprimtarie artistike me vlera të mëdha për letërsinë shqipe e më gjerë, konkurs ku unë gjeta një paralele me dimensione humane njëherazi për t’i dhënë frymë një autori të ri që sapo dha me sukses provën e parë në humor për ta sjellë në memorien kolektive, si gazetarja e karrierës dhe shkrimtarja Flora Nikolla, që bëri një akt të madh human, duke sjellë në fokus jo vetëm për homazh por edhe për ta bërë të njohur veprën e tyre pas vdekjes, si poetin satirik Teodor Keko, apo emigrantin anonim Ardian Kondakçi, në një konkurs me përmasa të mëdha si ky me emrin e merituar “Niko Nikolla”. Dhe ëndrra e Dori Kekos një intelektual i shquar e gladiator i luftës për ndryshime demokratike si deputet në parlamentin shqiptar pas pluralizmit të vendit dhe me penën e satirës si poet i shquar në këtë gjini erdhi me këtë vlerësim të merituar me çmim të kryeveprës së tij në vargje satanike, “Etj etj”, do të thosha, ashtu si për një poet të huaj anglez (S. Ruzhdie) që tronditi botën dhe kohën me vargjet e tij. Ky kundër obskurantizmit modern fundamentalist dhe i dyti kundër obskurantizmit komunist të diktaturës në Shqipëri. Kështu dhe ëndrra e tim vëllai Ardianit pas botimit të librit të tij të parë e të vetëm me humoreska, si ëndrra më e bukur e një emigranti falë pjesëmarrjes dhe vlerësimit me “Diplomën e Mirënjohjes” në këtë Konkurs të veçantë në llojin e letërsisë që u bë realitet në këtë konkurs dhe po aq mirënjohëse dhe e vlerësuar ndihem edhe unë nga organizatorët e kësaj feste të vërtetë, të cilët i falnderoj nga zemra e veçanërisht zonjën Flora, ose miss Buzëqeshjen, që parapëlqej ta thërras publikisht që me optimizmin dhe humorin e saj të pashtershëm.



Dielli i bukur që na shoqëroi gjatë gjithë kohës në veprimtaritë e konkursit dhe dashamirësia e shkrimtarëve Doranin Agalliu e Kadri Tarelli, me të cilët udhëtuaam që nga Durrësi për në Korçë, por edhe komunikimi me organizatoren, të ëmblën Nina Leka dhe realizimi grafik i videove nga Elvira Çiraku e stafi, i dhanë nuanca paqeje ankthit tim, sepse pashë që në atë konkurs humori ku e qeshura ishte gjuha e përbashkët dhe bisedat nxitëse mes autorëve si libër më vete, madhështorja u përul mbi njerëzoren duke u shkriur këndshëm mes alegrisë që përçonin miqësitë e reja e ndërtuese, falë prezencës së autorëve nga Shqipëria, Mali i Zi, Lugina e Preshevës, Maqedonia e Veriut, Kosova, Italia, Gjermania dhe Greqia. Mbresëlënëse ishte edhe organizimi dinjitoz i aktivitetit treditor, i cili nisi me hapjen e panairit të librave ndërthurur me ekspozitat e karikaturave të Endri Beqos dhe Arben Çejkut, duke vijuar më pas në shtëpinë muze të të madhit Dritëro Agolli në Menkulas, e deri te mbrëmja gala me ndarjen e çmimeve dhe emocionet plot humor e të qeshura që të përcollën nga skena e teatrit “Andon Zako Çajupi” në Korçë, autorët pjesëmarës me copëza nga jeta dhe krijimtaria e tyre.

Mbështetja e institucioneve dhe bizneseve të Korçës, falë edhe emrit të madh që ka ky qytet në art e kulturë, ishte e dukëshme. Konkursi nuk pati kësaj here fonde të planifikuara më parë nga institucionet shtetërore, apo Ministria e Kulturës dhe u zhvillua me këmbënguljen e organizatorëve dhe me kontributin e përkrahjen materiale financiare të donatorëve të ndryshëm privatë si dhe Bashkisë Devoll me kryetar Edi Duro, nën kujdesin e Prefektit të qarkut Korçë zotit Nertil Jole, që si artist edhe vetë ka një qasje të dukëshme për kulturën e artin në Korçë duke i parë si mbështetja më e madhe për zhvillimin e industrisë së turizmit që gjeneron më shumë se çdo sektor tjetër i ekonomisë të ardhura në këtë qytet, duke e kthyer atë për mijëra vizitorë gjatë gjithë vitit në një qytet “Korça Top – Fest”. Do përmendja gjithashtu bizneset “Meri butik”, “Sidheri”, “Sellca” Bilisht, hotel “Grand”, që na ofruan mikpritje e akomandim për dy – tri ditë si dhe z. Fatjon Selimaj që na shoqëroi në mbarëvajtjen e gjithë organizimit. Qershia mbi tortë e Konkursit ishte

shpallja e veprave fituese me çmime të veçanta sipas gjinive të humorit nga një juri profesionale që kryesohej nga shkrimtari, botuesi e producenti i njohur i librit të entit të madh shqiptar “TOENA” zoti Fatmir Toçi, njëherazi edhe piktures me organizimin e kolonive të saj brenda e jashtë vendit, ashtu si dhe të panairëve të librit e mbi të gjitha si një njohës i thellë i letërsisë dhe artit, me anëtarë aktoren e njohur Zamira Kita njëherazi Drejtore e Kulturës dhe Artit në rrethin e Korçës, që performoi njëherazi me mjeshtëri të larë plot emocion e humor galanë e organizuar me këtë rast në sallën e Teatrit A. Z. Çajupi, personalitete nga bota akademike dhe e medias si Henri Çili e Arta Marku, si dhe vetë e “zonja e punës” Flora Nikolla, të cilët e patën të vështirë deri në fund për të vendosur për autorët më të dalluar mes 31 pjesëmarrësve nga bota shqiptare, gjë që krijoi çaste interesante. Krijuesit duan të ndihen të vlerësuar, por juria kish parë fituesit përtej veprës së paraqitur dhe nderoi me Çmimin e Madh të Konkursit – Çmim Karriere për kontributin e çmuar në zhvillimin cilësor të kulturës, artit dhe veçanërisht humorit në Shqipëri, aktorin e regjisorin e njohur të kryeveprave të kinokomedisë shqiptare, veteranin e revistës “Hosteni” me dialogjet, gazmoret, anekdotat e karikaturat me një stil të veçantë në faqet e saj, njëherazi skenarist, karikaturist me famë edhe jashtë kufijve të vendit, zotin Bujar Kapexhiu “Nder i Kombit” njëherazi, i cili kësaj here solli skicat e veta të përmbledhura në një libër me vargje humoristike, ku humori dhe ironia për probleme të ditës që e përshkon nga filimi në fund është edhe estetika e seriozitetit të komikes. Humori na ndihmon të jetojmë më gjatë, do të thosh Kapexhiu si një nga ikonat më të kompletuara të artit në Shqipëri me dimensionet e saj, por për artistin nuk ka kufij karriere e pensione, sepse mbetet i tillë deri në rrahjet e fundit të zemrës së tij. Arti më shumë se mendim, është ndjenjë dhe njerëzit kanë nevojë të qeshin çdo ditë. Le t’i bëjmë të qeshin me të gjitha. E qeshura është vërtet terapia më e madhe, që nuk ka efekte anësore. Përndryshe Zoti nuk do të na i kishte dhuruar, duke na privilegjuar mes botës së gjallë. Faleminderit. Me Çmim Karriere u vlerësua pas vdekjes dhe poeti i njohur satirik Teodor Keko për poemën e tij epokale, si një nga kryeveprat në gjininë e humorit në letërsinë shqipe “E të tjera etj”, përgatitur e botuar nën kujdesin e bashkëshortes së tij. Gjithashtu me këtë Çmim u nderua edhe një nga fabulistët e famshëm të humorit shqiptar e më gjerë zoti Ferit Lamaj, i cili ndodhej ndërkohë në një Festival ndërkombëtar të kësaj gjinie në Bruksel. Kurse shkrimtari Thoma Goga u vlerësua me Çmim të Dytë për fejtounin “Me brekë nëpër këmbë”, megjithëse kjo gjini, ashtu si pamfleti i takon më tepër publicistikës se sa letërsisë humoristike.

Disa nga veprat e vlerësuara në konkurim do të botohen nga Shtëpia Botuese “TOENA”, presidenti i së cilës F. Toçi, tërhoqi vëmendjen për t’i ofruar më tepër letërsi humoristike lexuesit, si dhe për dramaturgjinë shqip, duke përmendur faktin për dramën e komeditë e autorëve të antikitetit si Eskili, Sofokliu, Euripidi, Aristofani që: “sikur mjaft prej tyre mos kishin qënë të botuara, nuk do të kishin shpëtuar e ardhur në jetë sërish nga teatri në skenat botërore”.

Konkursi ishte si një dasmë e vërtetë, që i dhanë një karakter të tillë vajzat dhe djemtë valltarë të Ansamblit të Bashkisë Bilisht veshur me kostume folklorike plot ngjyra të krahinës, që i bënë magjike ditët në Korçë e Devoll dhe në Menkulasin e Dritërojt, veçanërisht me vallen Devolliçe, e cila është jo vetëm pasuri unike e trashëgimisë kulturore e shpirtërore të krahinës, por gjithë

Shqipërisë, ndaj veprimtaria pranë muzeut që po ngrihet në kujtim të jetës e veprës së tij, i tejkaloi kufijtë e performancave artistike, sepse të gjithë banorë të fshatit e miq, ndërkohë ishin spektatorë, aktorë, valltarë e këngëtarë. Pritja filloi me raki nga ajo e nënës që pinte dhe vetë poeti që la amanet siç përmendi komediografi Skënder Demolli nga këto anë postulatit se “Nga rakia dhe nëna nuk shahet”. Lumë u derdh vërtet ashtu si urimet për festat e fundvitit e njëri-tjetrin gjatë përshëndetjeve nga shkrimtarë e personalitete që sollën në kujtesë Dritëroin si të ishte aty mes nesh, por dhe me dëshirën për ta parë sa më shpejt këtë vepër të vizitueshme (deri në tetorin e ardhshëm siç garantoj kryebashkiaku Eduart Duro që ia bëri fora edhe në një nga restorantet me emër si “Sellca” përgjatë udhës së Doganës së Kapështicës, ku luajti dhe “qeni i kallanxhiut”) – muze që e bën Devollin, vendlindjen e Agollit të madh, një atraksion të veçantë turistik, e ruan në memorie ikonën e tij, si një ndër majat më të larta të humorit e satirës në letërsinë tonë. Madje u shkrep edhe fotoja ekskluzive me vizitorët e parë nga soji i artistëve dhe shkrimtarëve, siç ishin pjesëmarrësit e këtij Konkursi që ardhur enkas me autobus, të cilët i përshëndeti “onlain” nga Tirana vajza e Dritëroit Elona, përshëndetje të cilën e përcolli plot emocion simotra e saj Flora Nikolla që ruajnë si të shenjtë mes tyre miqësinë e prindërve të tyre. Natyrisht si pas çdo dasme ka edhe qejf mbetje dhe vetë pjesëmarrësit e përcollën me humor për njëri në Devoll që në vend të priste dhurata nga të ftuarit, ua shpërbleu ai me nga një të tillë. Dhe kur u nda i kënaqur me të gjithë, i afrohet i vëllai dhe i thotë: “Po si nuk të ardhni turp, që edhe mua ma bëre dhuratën njëlloj me të tjerët që i ke botë?!” Ka më shumë ditë përpara se kuleçë dhe Konkursi i katërt i letërsisë së humorit mbledhet sërish në Korçë (e ku tjetër më mirë se këtu nga ku kanë dalë numri më i madh i shkrimtarëve, komediografëve, aktorëve e regjisorëve të humorit)? Se ka humor, për këtë dhe Korça lakohet për kulturë, tolerancë e qytetërim bashkëkohor. Në një prej shesheve të saj stoisur si tërë qyteti për krishtlindje e Vitin e Ri, m’u kujtua që vëllai im Ardiani, nga i vetmi udhëtim që bëri në Korçë në rininë e tij, më solli mua, motrës së vogël, një mollë të madhe jeshile me pika të bardha, sikur të ishte e pikturuar me dorë. Aroma e saj u bë kujtim që nga fëmijëria e më shoqëroi ndër vite, si një simbol mistik për këtë qytet, deri në atë moment në skenë kur pikërisht edhe unë, në udhëtimin tim të parë nga Korça i çoj dhuratë atje ku prehet në paqe te shtëpia e tij e fundit një Diplomë Vlerësimi për krijimtarinë e tij humoristike dhe kontributin modest që dha për zhvillimin e humorit, si përfaqësues për pjesëmarrjen në këtë Konkurs unik në Shqipëri. Thonë që “sensi i humorit karakterizon çdo njeri, por del në pah veç kur gjendesh me njerëzit e duhur”, prandaj nxitur nga njohja e afërt me miqtë humoristë dhe shkrimet humoristike të vëllait, kam provuar edhe vetë të shkruaj e s’është çudi që të ndodhem sërish në një veprimtari të tillë, sepse e qeshura i afron dhe i bashkon njerëzit, i bën më të lumtur.

Suksese Konkursit dhe autorëve që lëvrojnë këtë gjini aq të dashur për lexuesin e shikuesin!






Punëtorja HiTHi





Shkruan: Tome Trajkov, bartës i programit të Qendrës së Stripit në Maqedoninë e Veriut

- Para së gjithash, dua të theksoj kënaqësinë time të madhe që po marr pjesë në Ferizaj për herë të tretë.
- Kjo është hera ime e tretë që marr pjesë në këtë festival. Edhe pse fusha e "karikaturës" është e ndryshme nga fusha e "komikëve", kjo nuk do të thotë që organizata pritëse planifikon aktivitete për të afirmuar artin e 9-të në këtë territor.
- Nëse gjatë vizitës sime të parë bëra një premtim publik se do të ndihmoja në zhvillimin e komikëve në territorin e Kosovës, tashmë gjatë vizitës sime të dytë mbajta një leksion në shkollën e mesme lokale, dhashë një intervistë dhe organizova një ekspozitë të komikëve bashkëkohorë maqedonas.
- Gjatë vizitës sime të tretë, angazhimi im konkret vazhdoi.
- Së bashku me ndihmën e pakursyer të autores së re dhe premtuese të komikëve Angela Petrushevska nga Shkupi, më 23.09 mbajtëm një seminar disa-orësh komik për talentet e reja nga ky qytet. Ata treguan interesIM të madh dhe talent që duhet të zhvillohet më tej.
- Në ceremoninë e hapjes, momenti më prekës ishte fjalimi i Vlora Gorancit me një fjalim përshëndetës emocional dhe çmimi "Luljeta Kujtimi Goranci - shpirt i lirë artistik" në nder të nënës së saj të ndjerë. Çmimi iu dha artistes nga Polonia, Izabela Kowalska.
- Unë personalisht e takova znj. Luljeta në vitin 2009 gjatë vizitës sime të parë në Prizren. Pashë se ajo ishte një zonjë e vërtetë, një person shumë pozitiv, por edhe një krijuese serioze. Takimet e tjera u përsëritën gjatë festivalit në Ferizaj.
- Isha i nderuar që e njoha. Kosova ka diçka për të cilën të vajtojë dhe familja e saj ka diçka për të cilën të jetë krenare!
- Tani po kthehem te tema e komikëve dhe zhvillimit të tyre në territorin e Kosovës.
- Propozoj;
 - Gara të rregullta komikësh për nxënës nga të gjitha shkollat në Kosovë. Pas këtyre garave, duhet të praktikohet praktika e organizimit të ekspozitave dhe botimit të katalogëve.
 - Ajo që është një përvojë nga e kaluara, është drejtimi i temave komike për të qenë "pozitive" pa kujtuar momentet tragjike të veprimeve ushtarake në këtë territor. Kjo pengon kreativitetin e talenteve të reja.
 - Edukim i rregullt dhe më i detajuar


- • Pjesëmarrje në gara të organizuara nga festivale të tjera, por edhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare me bashkëmoshatarë nga vende të tjera.
 - Rezultatet do të vijnë vetë.
 - Ne filluam dhe do të vazhdojmë!
-
- First of all, I would like to emphasize my great pleasure that I am attending Ferizaj for the third time.
 - This is my third time attending this festival. Although the field of "caricature" is different from the field of "comics", this does not mean that the host organization plans activities to affirm the 9th art in this territory
 - If during my first visit I made a public promise that I would help in the development of comics in the territory of Kosovo, already during my second visit I held a lecture at the local high school, gave an interview and organized an exhibition of contemporary Macedonian comics.
 - During my third visit, my concrete engagement continued
 - Together with the selfless assistance of the young and promising comic author Angela Petrushevska from Skopje, on 23.09 we held a several-hour comic workshop for young talents from this city. They showed great interest and talent that should be developed further.
 - At the opening ceremony, the most touching moment was the address of Vlora Goranci with an emotional welcoming speech and the award "Luljeta Kujtimi Goranci - free artistic spirit" in honor of her deceased mother. It was awarded to the artist from Poland, Izabela Kowalska.
 - I personally met Ms. Luljeta back in 2009 during my first visit to Prizren. I saw that she was a real lady, a very positive person but also quite creative. The next few meetings were repeated during the festival in Ferizaj.
 - I was honored to have known her, Kosovo has something to mourn and her family has something to be proud of!
 - Now I return to the topic of comics and its development on the territory of Kosovo.
 - I propose;
 - • Regular comics competitions for students from all schools in Kosovo. After these competitions, the practice of organizing exhibitions and publishing catalogs should be practiced.
 - • What is an experience from the past is the direction of the comic themes to be "positive" without reminding of the tragic moments of the military actions in this territory. This prevents the creativity of the youthful talent
 - • Regular and more detailed education
 - • participation in competitions organized by other festivals, but also participation in international projects with their peers from other countries
 - The results will come by themselves. We started and we continue!
 -
 -
 -









The egg and the avocado
















Imria me hithi n'dorë

*

Danimarka e Belgjika kërkojnë të bëjnë marrëveshje me Kosovën që të burgosurit nga atje të sillen në Kosovë për ta vuajtur dënimin.

- Si mund të besohet që Kosova mund të ofrojë siguri se të burgosurit nuk do të arratisen, kur Gjyqi i Hagës për Kosovën u deklarua se Kosova nuk mund të ofrojë siguri për tre-katër politikanë të Kosovës që po mbahen atje qe pesë vite?! Ky veprim bëhet edhe më i çuditshëm, që Kosova të bëhet burg për Evropën, kur po bënë përpjekje të bëhet pjesë e Evropës!

*

Aq shumë ju ka dalë boja disa politikanëve, sa po më duket se po kalojmë nga jeta me ngjyra, në jetën bardh e zi!

*


Banka Botërore tha se ekonomia e Kosovës ka rënie.

- Mos u brengosni - thanë pushtetarët. Ka edhe më keq!

*

Disa po ankohen se po konsumohet duhani në ambiente të mbyllura e nuk po meren masa kundër tyre, ashtu si parashihet me ligj.

- Ne duhet t'u falënderohemi duhanpirësve që nuk po ankohen, se ne të tjerët po e thithim tymin e duhanit gratis!



*

Sot asgjë nuk është gratis, pos tymit të duhanit në ambientet e mbyllura, për ata që nuk konsumojnë duhan!

*

Për aq sa po zgjatë fushata, disa njerëz që nuk i njeh as lagjja e vet, po ndjehen aq të mëdhenjë, sa po mendojnë se janë duke kandiduar për kryetar shteti. Po të zgjaste fushata më shumë, edhe Kina do t'u dukej e vogël, karshi “madhështisë” së tyre!

*

Në kohë fushate, kandidatët për poste politike po flasin e po premtojnë aq shumë, sa nuk po përdorin as presje, e le më pikë, sa të marrin pak frymë, e kur po fitojnë, pas fjalës së parë po ia çesin pikën e nuk po vazhdojnë më tej!

*

- Ne, në mandatin tonë katërvjeçar i kemi mbjellur njëqind mijë drunj.
- I keni mbjellur njëqind mijë, e i keni prerë dyqind mijë!
- Jo! Drunjtë i kanë prerë ata që e kanë fituar tenderin për t'i prerë!

*

Kur njerëzit me tituj shkencorë vrapojnë pas politikave gjysmanalfabetë, tregojnë për nivelin e titujve që i kanë fituar!

*

Të kandiduarit për zgjedhje po e xhirojnë veten nga toka dhe nga ajri, për të dalur sa ma bindës para zgjedhësve, dhe një kandidat kishte porositur një xhirim nga sateliti. NASA, pas një analize kishte ardhur në përfundim se e paska zbuluar një galaktikë të re (koka tullace e kandidatit e rrethuar me pak flokë anash, u kishte ngjarë në galaktikë)!



*

Ata që po mundohen ta falsifikojnë historinë, po i marrin si “dëshmi” ca fotografi me gurë të vjetër, por të murosuar me suva të re!

*


Në prag të zgjedhjeve lokale, shumë nga kandidatët për poste politike po i thërrasin votuesit ta pijnë kafën e mëngjesit bashkë, edhe atë në mesditë!

- Nuk kanë faj ata që flasin rrokopenla, por ne që u besojmë kur mesditës i thonë mëngjes!

*

Këtë muaj, në Kosovë u organizua Festivali dhe Panairi i Librit për fëmijë.

- Që të jetë sa më i suksesshëm ky festival, do të ishte mirë që librat të bëheshin nga çokollata e jo nga letra, që t'i joshin fëmijët për t'i blerë!



*

Gjatë kësaj fushate, shumëkush ka fluturuar aq lart, sa është dro se kur të bien me këmbë në tokë, mund të pësojnë shumë keq!

*

Në një takim elektoral u tha se disa nga institucionet tona e kanë të pazhvilluar shkronjën “ZH”, që don të thotë zhvillimin!

- Për fatin tënë të keq, shkronja “Zh” ndodhet në fund të alfabetit, e ata ende janë tek shkronja “A”, se prioritetet i kanë vendosur sipas renditjes alfabetike!

AFORIZMA



Jovan Jovčeski

Prilep, Maqedonia e Veriut

1. Populli leh, karvani i politikanëve ecën!
2. Idetë i kanë të freskëta, por realizimit i ka skaduar afati!
3. Nuk ta heqin kapelën, ata që ta qepin!
4. Nuk na e qepin kapelën, për të na i shpëtuar kokat!
5. Ishim një urë midis njerëzve, por qeveria nuk na mbështeti, kështu që nuk mundëm ta kalojmë atë!
6. Disave, sukseset nuk u vijnë brenda natës, por përmes fuqisë që kanë!
7. Disa punë të liga nuk vjetrohen. Ato rinojnë!
8. Ishte shumë i hapur dhe u avullua shpejt.
9. Hetimet po vazhdojnë, por gjithçka po rrjedh e po ndryshon!
10. Ai jo vetëm që është i pafytyrë, por është edhe fytyrë e dyshimtë!
11. U pasurua brenda natës. Ditën i varfëroi të tjerët!
12. Nuk dua ta mposhtë veten. Kam mjaft disfata!
13. Kaloj, nga fjalët në vepra. Kriminale!
14. Që t'mos ma punojnë pas shpine, nuk ua kthej shpinën!
15. Zanatet ia lamë historisë. Dhe historia është zanati ynë kryesor!
16. Sekretet e suksesit tonë është suksesi i sekretit tonë!
17. Politikanët nuk lënë përshtypje të mirë. Vetëm marrin!
18. Krimi nuk rritet. Përhapet!
19. Politikanët i shërbejnë popullit. Si shembull i keq!
20. Me politikanët, populli është në humbje. Dhe duhet të falimentojë!
21. Ata do të ma falnin suksesin. Nëse nuk e arrijë!
22. E uruan publikisht për suksesin, me dëshirën e fshehtë që të mos e përsëris atë!

Imri Musliu: Në logun e hithave

*

- A i ka dalë Hamides bakllava e mirë o Asllan Aga?
- Valla kojshike, dorën n'zemër, bakllva jote po del ma e mirë, thuja përherë.
- Mos po do me thanë që jam ma e zoja se Hamidja jote, Asllan Aga?
- Nuk muj me thanë që je ma e zoja, po furrën e ki ma t'mirë se t'Hamides, se beli po t'i pjek mirë bakllavat!

*

Për ata që po përhapin energji negative në Fejsbuk, mendova me ju propozu me dalë n'mal e me e zbrazë krejt atë t'keq që e kanë në mbrendi, po kur m'shkoi mendja se munden me e tha malin, u tërhoqa. Tash jam në dilemë: Dam ma i madh bahet që na stresojnë neve, a që e thajnë malin?

*

- Pse p'e k'qyrë qenin o Xhymë?
- P'e k'qyri qysh p'i ha esht'nat e pulës, krrap, krrap, krrap e po ja marr lakmi. Po tham, t'i kisha pasë edhe unë dhamtë si t'tina.

- Qysh bre Xhymë p'i merr lakmi qenit?!

Njeri kur po u plak'ka, p'i marrka lakmi edhe qenit, Asllan!



*

- Pse ishe te doktori, Xhymë? Je pa qef a?
- Nuk po muj m'u ngjitë përpjetë shkallëve, Asllan.
- Ngjitu me lift!
- Ashtu m'tha edhe doktori!

*

- Oj plakë! Nuk po muj me prashitë bahçen me shati. A ta blejë një motokultivator t'vogël me freza?

- A kish pllug?
- Nuk ka nevojë, se frezi po shkojke fell 15 centimetra.
- Jo plak, nuk ashtë boll 15 centimetra. Kqyr a ka frez që shkon fell, bile 20 centimetra!

*

- A e gjete naj nuse n'atë farë Realliti Shoun ku ishe o bir?
- Jo babë! I dhash zor, po nuk pata fat.
- Hajt mos u ban marak, se t'marton baba!
- Niherë jo, se nuk jam gati!
- Ah bre bir! Kogja do vjet i ke ba, e nuk do me u pjekë, po m'doket.
- E more babë! A e di ti që n'Realliti Shou m'kanë ba zaven's babë?
- Unë jam tu deshtë me t'pa tu u ba babë, e jo zaven's babë, o ahmak?!

*

- Ku po shkon o bir k'shtu?
- Po shkoj në Sofrën Poetike.
- Prit se po vi edhe unë!
- Hahahah! Kur u bane poet o babë?
- Çfarë poeti bre?! Po du me ardhë n'sofër, se bash m'ka marrë malli m'u ungjë n'sofër si k'tyne here kur shkojshim n'darsma.
- Jo, jo! Sofër i thojnë, po nuk ashtë sofër ku shtrohet buka!

- Haj, haaaaaaj! Vakt o vakt! Unë e di që sofra ashtë për me shtru bukë, po e paska rrutllu qeshitin edhe ajo! Zot bane hajr!

*

- A u pensionove?
- Po! Tash kam m'u k'naqë tu punu.
- Mos po do me thanë, tu pushu.
- Jo, jo! Sa isha n'punë, pushojsha n'punë, e tash masi nuk kam ku me pushu, duhet m'i grahë punës.

*

- Luan! A po m'çon n'Berat bre bir, se e njeva televizorin që i përmeni do selvija t'Beratis e po kam qef m'i pa. Tash jam plakë kogja, po veç po kam qef me ditë pse përmenen ato selvia? Shka kanë ato ma shumë se gratë tona?
- Cilat gra o babë?
- Selviat de!
- Selviat nuk janë gra, po janë do druj si n'kajde t'pishave që rriten t'holla e t'gata, diqysh si plepat!
- Jo bre bir, sa për plepa i kam plepat e mi, e tybe n'po shkoj n'Berat!

*

- Alo, alo bir! A po m'i ep do pare, se kam metë pa to.
- Po babë. Hajde merri paret.
- Qysh me ardhë? A t'thash që nuk kam pare?!
- Po, bash që nuk ki pare, hajde merri paret.

Jo, se pa pasë pare, nuk muj me ardhë me marrë pare!

*

- Nga të kemi ore?
- Jam nga Malësia.
- Nuk ka gjë në Malësi. Vetëm gurë e dru!
- Juve nga ju kemi?
- Unë jam nga deti.
- Deti nuk ka as gurë as dru. Ka vetëm ujë që nuk pihet!

*

- Babë, a t'çojmë te doktori, se t'myti kolli?
- Blem'na një shurup, se ju e dini që i kam tullusum doktorrt!
- N'i paç tullusum doktor't, po t'çojmë te ni doktoricë.

- Eh, ashtu ban, se doktorricat e kanë dorën e lehtë!



*

- O plak! Pse nuk p'e k'qyrë Big Brodherin e me pa shka bajnë burrat për gra?
- Pse a pak po t'doken 300 krushq që t'i çova me t'marrë a?!

*

- Ah Asllan! Nuk ka ma lezet me dalë n'shehër si k'tyne here, kur dalshim me kual n'pazar e u k'naqshim!
- Lee Xhymë, se tash edhe me pasë kual, nuk guxojmë m'i lanë vet, se ja

u vjedhin patkojt e i shesin për
hekur*!

*

- Pse ti babë nuk bërtet kurrë?
- Se jam m'su nidajm me m'bërtitë
tjer't.
- Pse po t'bërtasin?
- Po m'bërtasin, pse nuk po bërtas!

*

- Pse Asllan, nidajm ke folë për ni odë
t'veçantë, e nuk e marove kurrë?
- Nuk e marova, se me pas maru, kish
hi n'tâ i hunit e i konopit e ma kish
ba menen dhalhtë. Odën e kam
n'men. edhe aty po i „pres e
përcjelli“ shok't e mi ma t'mirë.
Qashtu po k'naqna me ta, tu „ngu“
veç muhabete t'mira edhe po ja zgati
jetën vetit!



*


Asllani e Ibishi e thirrin Xhymën me shku
me pa dikun (për ngushëllime), e Xhyma e
çon djalin, se vet ish kanë pa qef. Kur e mur
vesh Asllani, tu e njoftë djalin e Xhymës,

nuk i erdh mirë, po bani menë, nashta veç ju bashkangjitet e nuk flet, edhe nuk e bani t'madhe këtë punë, po kur hinë mrena, djali k'cej diqysh si pa ren e tha:

- Baba Xhymë ke si pa qef e m'u dasht me ardhë p'i dhive! Unë me dhi jam marrë p'i dhet vjeçe, po hajrin ja u kemi pa krejt familja, se p'i dhive po hamë, p'i dhive po pimë. Bile, p'i dhive erdha, te dhitë po shkoj!

Kur dolën jashtë, Asllani i tha Ibishit:

- Aaaa, që naj ka dhi t'pamen bre!



*

- Pse ti babë nuk ki flokë n'krye?

- Se unë i kthejsa n't'djathtë, nana jote m'i kthejke n't'shmajhtë. Masi nuk gjetëm kompromis, i hjeke krejt!

*

- O bir! A e lajte rrymën?
- Veç gjysën, se kish hypë.
- Pse nuk e more shkallën edhe e kishe sosë punë filhall?
- Jo, aty nuk po u dashke me pasë shkallë, po pare!

*

- Qysh je Asllan?
- Kurrqyshë Ibish! Marova prej lukthit. Zaherë ashtë kalbë, tu munu m'i majtë mrena fjal't e budallme t'Xhymës e t'qiftave t'tij, po hajde e kallim ka ni duhan, se pa ja çitë timin kaniherë qeshtu, m'doket m'del timi!

*

- O babë! Ma mirë unë që nuk deshta me shku n'mal, a baci që shkoj, e e kish harru sakicën n'shpi?
- Mirë, as ti as baci. Ti keq, baci daha, daha!

Bekim Gaztori
MUSHKONJAT E GAZETËS

Kjo botë ka parë... pafund demokraci...

FJALËN E LIRË fuqishëm tek premtojnë,

Po kur ka artikuj që s' (munden) me i kapërdi,

Atëherë gazetarëve punët ua ngushtojnë.

Kështu na ishte dhe në mbretërinë zogiste.

Ku pasanikë e lypsarë kishte pa mbarim,

Edhe pse liri e mendimit bukur e gjerë na ishte!

Po ja që një gazetar e kuptoi ca gabim.

Bëri për gazetë një shkrim për Mallakastër,

Për varfëri dhe mushkonja në shira dhe të nxehtë,

Bubu si janë milionëshe të rrasen në bukë dhe gojë...

Kjo kritikë gjithë mbretërinë e vuri në siklet.

Kaluan disa javë dhe ai numër gazete shkoi,

Por mushkonja në Shqipëri prapë ishin anembanë,

Bile njëra nga ato dhe vete Mbretin e pickoi,

Mu në Pallatin Mbretëror atje në Tiranë.

Ndaj hetuan mushkonjat - rrugët n'Tiranë kah vijnë?

A vinin nga gazeta- që ish' shitur kaherë?

Tash dalin nga miliona gojë që fyjnë dhe nxijnë mbretërinë,

Ndaj xhandarmërisë i dhanë një urdhër të prerë.

Dhe xhandarët dolën një ditë - në rrugë pa ispatë,

Ja dhe gazetari i mirë - bash ai mu i lapsit...

Ministrat dhe vetë Mbreti qetësohen - bëhen rehat ...

Me gazetarin mbështjellë në lëkur të dashit

....

Mushkonjat vazhdonin përsëri të dilnin,

Në Tiranë dhe Mallakastër gumëzhimë prapë përherë,

Nën lëkurë dashi mes ethesh - një idesë seç i zuri fillin,

Dhe nuk priti të shërohej - po veç ca me u këndellë...

"E pranoi" se mushkonjat - dilnin veç nga shkrim i tij,


Kështu mësyu në Tiranë - me i gjet' vetit çarën,

E bëri për gazetë shkrimin me i titull krejt të ri, të ri,

MALLAKASTRA NGA SOT E KA MARR TË MBARËN!

Galeria HiTHi

Ju prezentojmë karikaturistët francezë të cilët morën pjesë në Edicionin e 11-të të Festivalit Ndërkombëtar të Karikaturës, Ferizaj 2025





Bernard Bouton



Gerald Peigneux





Jean-Loic Beloni






Nader Hafezi







Oleg Dergachov

Aforizma nga Ninus Nestoroviq



Ninus Nestoroviq

U lind në vitin 1965 në Smederevska Pallankë. Jeton dhe punon në Novi Sad. Është anëtar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Vojvodinës, ku është edhe president i Seksionit të Humoristëve dhe Satiristëve.

Aforizmat e tij janë përkthyer në: italisht, polonisht, spanjisht, anglisht, sllovenisht, bullgarisht, maqedonisht, rusisht, çekisht, baskisht, hungarisht, rumanisht dhe gjermanisht. Ai përfaqësohet në antologji të aforizmave serbe, të cilat janë përkthyer dhe botuar në Itali, Rajonin Bask, Poloni, Slloveni, Rumani dhe Rusi.

Ka botuar: Mendime të rrudhosura (1997) (1999); Lidhje e pathyeshme (2003); Sekretet ushtarak (2006); Mbylle dhe noto (2014); Zot, na bëj të thjeshtë (2020); Redaktoi antologjinë me aforizma të Novi Sadit, Vula e Kohës (2003); Diktatori dhe unë (2021); në polonisht Aforizmat e mbrojtura (2022); në

maqedonisht Zot, na bëj të thjeshtë (2023); në sllovakisht 11:52 (2025);

Është fitues i disa çmimeve të rëndësishme:

Çmimi VIB i dhënë nga gazeta "Politika" (2000); Helmeta e Artë në Festivalin Ndërkombëtar të Humorit dhe Satirës në Krushevac (2000);

Katër çmime të para tre të dyta, dhe dy çmime të treta për aforizma në Çivijada në Shabac; çmimi "Bijeli Pavle" për aforistin më të mirë në Festivalin e 5-të të Humorit dhe Satirës në Danilovgrad të Malit të Zi; çmimin "Dimitrije Frušić" të dhënë nga Shoqata e Gazetarëve të Vojvodinës (DNV) në Novi Sad (2008); Pllaka e Artë për aforizma në Festivalin e 14-të Ndërkombëtar të Aforizmave dhe Karikaturave - Strumicë (2013); Çmimi "Vuk Gligorijević" në Festivalin e 11-të të Satirës (2013); Libri më i mirë i aforizmave (2014); Çmimi Naxhii Naman (2015); Çmimi për aforizmat më të mirë - "Çivijada" (2017); Çmimi "Vuk Gligorijević" në Festivalin e 16-të të Satirës (2018); Çmimi për aforizmat më të mirë - "Çivijada" (2019); Pllaka e Artë për aforizëm në Festivalin e 21-të Ndërkombëtar të Aforizmave dhe Karikaturave - Strumicë (2020); Çmimi "Tipar" 2020; Pllaka e Argjendte "Jas, Itar Pejo" (Maqedoni e Veriut) 2020; Çmimi "Radoje Domanoviq" (2021); Çmimi i Shoqatës së Shkrimtarëve të Serbisë (UKS) si më i miri aforist në kuadër të "Kabaresë së Komedisë së Rrugës Verore" në Çajetinë, 2016, 2021; Çmimi "Radomir Rackovic" në Festivalin XXI të Humorit dhe Satirës në Danilovgrad (2021); Çmimi "Jovan Hadži-Kostić" (20222) "Award Asociation" (Shoqata e Gazetarëve të Serbisë) (2022); Pllaka e Artë për Aforizëm - Festivali i Karikaturës dhe Aforizmit - Strumicë (2024); Çmimi i Parë - Ditët e Satirës "Pavle Tonçiq" - Zhitkovac (2024) etj.

Me profesion është inspektor i doganës dhe është baba i tre fëmijëve.

Në shtëpinë tonë, vetëm babai im e di se çka është demokracia.

Për të i kishte folur gjyshi.

E gjithë pasuria jonë përfundoi jashtë shtetit.
Paratë dhe arin i nxorën politikanët, e fëmijët shkuan vet!

Këtu vetëm rastet psikiatrike janë personalitete të realizuara.
Çfarë mendojnë, edhe bëhen!

Paqen që bëjmë, duhet ta zhbëjmë,
Ashtu që brezi i ardhshëm të ketë me çka të luajë!

Ne, jo vetëm që kemi kriminelë për të gjitha kohërat, por edhe të të gjitha moshave!

Dikush është polic, dikush kriminel, por dikush duhet t'i punojë të dyja punët që të mbijetojë!

Disa habiten që këtu ende votojnë të vdekurit. Mua më shumë më çudisin të gjallët.

Qytetarët e varfër e presin Vitin e Ri në rrugë, ndërsa ata më të varfërit, edhe ditët tjera ...

More çfarë prostitucioni!?

Ne, memzi e legalizuam krimin!

U shkatërrua komunizmi, u shkatërrua demokracia, por diktatura ende është e fortë!

Së pari e përзумë armikun nga këtu, pastaj i erdhi radha edhe popullit.

Deri më tani, secili pushtet ka investuar në kulturë. I ka blerë shkrimtarët, e jo librat.

Patriotizmi dhe pasuria e tij janë moshatarë.
Janë rritur bashkë.

Çfarë populli është ai që bënë jetë qeni, e as nuk lehë, as nuk kafshon?!

Të moshuarit tanë, vetëm vdekja mund t'i ndajë nga bashkëshortësia.
Nga lista e votuesve, as ajo!

Këtu nuk mund ta ndezësh vetëm flakadanin e lirisë. Të gjitha mjetet tjera piroteknike janë të lejuara.

Nganjëherë gjenocidi na godet ne, nganjëherë ata.
Varet se nga frynë era.

Më zgjoni para se të vdes.

Dua të përshëndetem me jetën.

Koka e zbrazët është ambalazhi më i mirë.
Në të mund të paketosh gjithçka.

Sot është regjistruar në fakultet, sot e ka
përfunduar.

Ai, asnjë punë nuk e le për nesër.

Po të flisnin të vdekurit, do të ndryshohej e
kaluara.

Për t'u ndryshuar e tashmja, duhet të flasin
të gjallët.

Më herët, populli kishte arsye të vdiste.

Tani nuk ka arsye as të jetoj.

Zgjedhja e së vërtetës, për ne është si
zugjedhja e misit.

Përherë e zgjedhim më të bukurën.

Gënjeshtrën e kemi mbështjellur në
ambalazhin më të lirë.

Në gazeta.

Pa investuar asgjë, nga ne bënë budallenj të
mëdhenj.

Kjo është dëshmi, se me pak para mund të
bëhen punë të mëdha.

Me gazeta nuk fshihen më dritaret, por e
vërteta.

Zoti është selektori më i mirë. Thirrjes së tij
të gjithë i përgjigjen.

Çfarë shteti është ai, kur mbi asfalt më
shumë vizatojnë policia se fëmijët!

Ju mendoni se këtu ka ende njerëz të
ndershëm?

Në kë po dyshoni?

Tani, gjithçka mund të thuhet, dhe thuaj, po
guxove!

Për dallim nga trafikku, qërimi i hesapeve në
mes grupeve kriminale në rrugët tona,
zhvillohet normalisht.

Për dallim nga mjeku, te varrmihësi nuk
kemi nevojë për orar, se përherë mbërrimë
me kohë.

Në konfliktin e gjeneratave, kanë pësuar ata
më të rinjtë.

Nuk i kemi lejuar as të lindin.

Shteti përherë është i pabesë.

I mashtron ata që e duan më së shumti.

I dyshuari nuk u mbajt shumë në
paraburgim.

Si vdiq, e liruan menjëherë.

Zinxhiri i prostitucionit ka më së shumti
vrime.

Vetes ia fshinë të kaluarën.

Ne, të ardhmen.

Gënjeshtra është botim i ndryshuar dhe i
plotësuar, i së vërtetës.

Atje ku ka vdekur demokracia, as votuesit
në listat zgjedhore, nuk është e thënë të jenë
të gjallë.

More çfarë diktature klasike?!

Kjo e rikomponuara po pëlqehet më shumë.

Ka kohë që më dhemb dhëmbi dhe shpirti.
Siç po shihet, duhet nxjerrur, edhe njërin
edhe tjetrin.

Barërat që blihen në pazar, mund të pihen
vetëm në tru të zbrazët.

Populli ynë përherë ishte miopë. Asnjëherë
nuk ka parë më larg se udhëheqësi.

Mua nuk mund të më blejë askush.

Unë jam ekzemplar gratis.

Lumë ata që i gëzohen fatkeqësisë sonë.

Përherë kanë arsye të gëzohen.

Gjithçka e privatizua.

Vetëm jetët tona ende janë në pronësi të
shtetit.

Gramatika, asnjëherë nuk ka qenë anë e
fortë e politikanëve tanë.

Përherë e kanë ngatërruar kohën e shkuar
me të ardhmen.

Ushqimi të cilin e konsumojmë, përherë
kontrollohet.

Ne jemi testi i parë dhe i fundit.

Dikur, pasuria më e madhe e jona ishin
njerëzit.

Pastaj ajo pasuri filloi të tretet.

Populli analfabet u përmbahet vetëm
rregullave të pashkruara.

Çfarë Hëne more?!

Ne ende nuk kemi zbritur në Tokë!

Njeriu në jetën e tij i bënë vetëm dy hapa: të
parin dhe të fundit.

Hapat tjerë janë vendnumërim.

Lehtë është të jesh hero në libra.
Atë mund ta vrasë vetëm shkrimtari.

Kot e ke nxjerrur “Pikën” nga nëntavolina.
Këtu “Xhandari” është letra më e fortë.

As udhëheqësi nuk do t’i rendiste gjithë ato
fitore, po t’mos i kishte simpatizuesit pas.

Deri më sot, asnjë popull nuk është liruar
nga robëria, për shkak të sjelljes së mirë.

Të varfërit, më lehtë largohen nga ushqimi
se nga televizori.

Më pak janë të varur.

Këtu ekziston vetën ditëlindja dhe
ditëvdekja.

Krejt tjarat janë netë.

Pushtetit të aftë nuk i duhet opozita.
Krejt punët i bënë vet.

Më lehtë është të merresh me politikë se me
kriminalitet, se më lehtë plaçkitet shteti se
banka.

Gjithkund në botë është zgjatur jetëgjatësia,
përveç tek ne.

Këtu ende jetohet, sot për nesër.

Sot, më mirë është të shkohet në luftë se të
punohet në ndërtimtari.

Në luftë, më pak vdiset.


Aforizmi i ka tri dimensione: gjatësinë,
gjërësinë dhe thellësinë.

Për dallim nga qytetarët tjerë, kriminelët më
nuk kanë nevojë të shkojnë jashtë vendit.

Për ta ka punë këtu, sa të duan.

Për udhëheqësit tanë, kamerat e televizionit
njëherit janë edhe kamera të sigurimit.
Ato ua ruajnë pushtetin.

Përktheu: I. M.



Karikatura: Goran Çeliçanin

LUAN LAZE AFORIZMA & PARADOKSE



Luan Laze, portret i punuar nga Agim Sulaj

1. Ai ndihmon të pasurit. Pranon lëmoshë që t'u shkojë mbarë atyre.
2. Dikur qaja për çdo gjë. Tani më vjen të qesh për qarjet e mia.
3. Sa të lirë kur jetonim me frikë dhe, sa frikë kemi në liri.
4. Gëzimet e marrëzisë shijojnë më shumë se sukseset e zgjuarsisë.
5. Dëgjoni të kundërtin tuaj. Unë dëgjoj zërin e një të ndershmi.
6. Bindjet politike anojnë nga veshi që pacienti nuk dëgjon fare.

7. Sot liria është e bukur se sëmundjet psiqike quhen art.

8. Mua më ngjajnë të gjithë ata që mendojnë si vetja tyre.

9. Fëmijëria është e bukur se disa i shoqëron edhe në pleqëri.

10. Pas banakut mendoj si të vjedh. Para banakut e di se më vodhën.

11. Sa e shëmtuar do ishte jeta nëse nuk do na gënjenin kurrë.

12. Një hakmarrës nuk di kush është pro, di kush është kundra.

13. Nuk e bën dot të lumtur atë turmë që punon kundra vetes.

14. Kur nuk qan as për dhimbjen tënde, loti e di se e ke merituar.

Fatmir MUSAI

ÇMIMET

Që të mos bëhen çmimet si këmbët e dhisë

E të kthehen në para kallp*,

Një ligj duhet të nxjerrësh,

Kuvend i Shqipërisë:

Çdo çmim e dekoratë të shoqërohet me zarf!

...

Shiheni pastaj podiumet kur të firojnë,

Sa pak oaze në shkretëtirë do të mbijetojnë

Edhe pse luanë e hijena aty do ngrehin prita,

Zarfin do ta marrë ajo mikluesja, Çita*!

*çita- grabitqarja më e shpejtë mbi tokë.

Faruk TASHOLLI

PARTIZIMET

Bien daulle n' muaj zgjedhjesh
Tek vlojnë tinëz bisedimet,
Hidhet vallja politike
Partitë shpalojnë aderimet!

Zihen trimat n' kazan Kosovë
Kush po del në ballë i pari,
Unë i fundit vesh e mora:
Pa parti nuk rron shqiptari

Partizohen gjeneralët
Partizohen pensionistët,
Po s' u bënë anëtarë partie
Kush s' i qas akademikët!

Ndërrojnë pozita gazetarët:
Pse të flasim për të tjerët?
Po s' ke facë politikanit,
Nuk të rru'jnë dot as berberët!

Ç' rrin ky popull me sy hapur
I varfëruar drejt ekranit?
Kush ia ngriti si Perëndisë
Atë kult lart politikanit?!

Kush don jetë e kush pret nder
Çfarë zanati s' ka rëndësi,
Nuk ta var jo rob i zotit
– S' ke pushtet po s' je n' parti!

Partizohen e çpartizohen
Për një fron mijëra shqiptarë,
Por në fund udhët ngushtohen
Kush t' zerë vend në rend të parë?!

Ferit LAMAJ

Ishulli

Ishull Shqipëria, ju bëj be, për Zotin!
Qeni, macja, dhia s' po njohin të zotin.
Eh, kjo Shqipëria jonë, tre milionë
Robinsonë...



Karikatura: Friedrih Tasser, Itali

MUSA I. AHMETAJ

TOP LAJMI

Lajmi mori dhenë
Sot pa hangër darkë
Fëmijëve dhe pleqëve
Dhuratë nga një qindarkë.

Pleqtë tash në fushatë
Paskan lënë dhe mbresa.
Edhe këta si fëmijët
Duan dhe pampersa.

Për dy mosha të ndryshme
Do bëhet kjo ndarje
Për festa të funditvitit
Të mos ketë përçarje.

Për festa të funditvitit
Ndarje reale hiç pa hile
Dhe pleqtë dhe fëmijët
Do marrin nga një jeshile.

Sevdail HYSENI

NËNTOR LUGINE –
“VEÇ SHQIP”

Nëntori në Luginë,
këtë vit si për çudi,
Na erdhi si mysafir
i dasmës me çifteli.

Na mbushi hare
me gëzim dhe kulturë,
Këngë e valle
“veç shqip” nën flamur.

Në këtë Luginë festive
pati diçka të paparë,
Edhe “politikanët”
sikur ishin futur në garë:

Kush më shumë të dukej
i veshur për bukuri,
Me plis të bardhë n’kokë
e flamurin kuq e zi.

U bë nami me aktivitete,
gjithandej, në Luginë,
Në këtë festë kombëtare
s’e prishi kush terezinë.

Nxënësit kënduan,
vallëzuan me flamur në dorë,
Mësuesit na u bënë poetë,
e poetët - moderatorë.

Madje disa portale u zgjuan
nga gjumi me vrik,
I thurnin lavde
Këshilli Kombëtar me taktikë,

Sa për të zhvatur ndonjë projekt
n’fund të vitit,
Duke lozur lojën haptazi
me misionin e mësimit.

Dhe çuditërisht,
Beogradi heshti,
si kurrë më parë, pengesë, asnjë “urdhër”,
e as gjobë në sirtar.

E luginasit qeshën lehtë
me humorin e tyre të artë:
- Hajt more! S’ka lidhje,
pas kafes pihet uji i thartë!
Spica Metalike

Sevdail HYSENI

KRAVATA

Njoh disa njerëz mësuar me kravatë,
Të lidhur rreth qafe, fort, ditë e natë.
Dikur i nderonin me epitetin “zotëri”,
Sot s’i bëjnë mall as gratë në shtëpi.

Disa prej tyre - e them pa pikë zori,
Askush s’i nderon, lumi seç i mori.
Humbën privilegjet, s’kanë pozicion,
Tani dhe kravata në qafë u rëndon.

I shihnin me sy si njerëz me “kulturë”,
Me këpucë të lustruara, sikur në maturë.
Me nder s’u ofron më kush kafe në bufe,
Veç faturat e rrymës - posi fletërrufe!

Daljen në pension e marrin si ngushëllim,
Siç thoshte Naimi - me pak mallëngjim:
Kur vjen pleqëria, s’të do as biri, as bija,
Edhe qeni, kur të sheh, ulet n’bisht e të lehë.

Kështu, kravata që dje i bënte “zotëri”,
Tani i shtrëngon për fyti me nostalgji.
Nga kjo humoreskë del një si mësim:
Kotësia e njeriut s’ka as fund, as fillim!
Spica Metalike

Anekdota nga Fazli Ferati, Klinë



Fazli Ferati u lind në vitin 1957 në Çabiq, Komuna e Klinës. Shkollën fillore e atë të mesme e kreu në Kijevë. Kreu Fakultetin Filozofik (dega Letërsi e gjuhë shqipe). Punoi si profesor i Gjuhës shqipe në SHFMU “Esad Mekuli” në Caravik të Klinës. Tani në pension. Është autor i 11 librave me poezi, anekdotë, dramë për fëmijë e kritikë letrare.

SHTËPIA ME RRASA

Në kohën e mëparshne, diku rreth viteve 60-ta në përgjithësi shtëpitë nëpër fshatra kanë qenë të mbuluara me rrasa, pastaj filluan aty-këtu kush ishte pak më i fortë ekonomiksht t'i mbulonin shtëpitë me

tjegulla. Një fshatar e mbuloi shtëpinë e vet me tjegulla edhe tani ai bukur i gëzuar, një ditë e takoi fqinjin e vet dhe i tha:

-Qysh pikë shtëpia me rrasa?

Fqinji iu përgjigj:

-Si ty dje.

SHOKU I NGUSHTË

Çdo njëri ka shok, disa më të ngushtë e disa jo edhe aq të ngushtë. Me kalimin e kohës pak a shumë ndryshon edhe shoqëria, disa ende mbesin shokë e disa të tjerë largohen.

Takohen dy vetë e pyesin një-tjetrin si i kanë punët me shokë.

-Po ti si i ke?

Ai i përgjigjet:

-Po, i kam disa shokë, por jo edhe aq të ngushtë siç i kam pasur, ngase kanë filluar të më zgjanohen.

T'I KURSEJMË TË HOLLAT

Dy vëllezër shkuan në qytet për të blerë disa gjëra për martesë dhe disa gjëra të tjera. Gjatë rrugës biseduan se çka donin të blinin. Ata pasi që arritën në treg filluan t'i blenin gjërat që ishin marrë vesh. E tërë dita u kaloi duke lëvizur poshtë e lart nëpër qytet, i

kishin harxhuar afër 1000 marka gjermane. Para se të vinte koha për t'u kthyer në shtëpi, njëri i tha tjetrit.

-Vëlla, ne i harxhuam këtë shumë të hollave, tani kam një ide për ju.

-Fol vëlla, - iu përgjigj tjetri:

-A t'i kursejmë paret?

-Si t'i kursejnë?, - ia priti tjetri.

-Mos t'hajmë bukë.

SA MË SKUQE

Një ditë njëri kishte ra në hall, ishte ngushtuar fort, i nevojiteshin disa të holla. Mendoj bukur shumë, nuk dinte si t'ia bënte, te kush të shkonte të kërkonte para hua. Pas mendimeve të shumta vendosi të shkoj të një fqinji i vet, që pak a shumë kishte shpresë që do t'ia gjente të hollat. Kur shkoi të fqinji, i tregoi se për çka e kërkonte.

- Nëse ke mundësi me m'i gjetë pak të holla, ngase po më duhen shumë - i tha.

Fqinji ia ktheu:

- Po më kuqë shumë, por nuk më kanë qëlluar.
- Ky që kishte nevojë për të holla i tha:
- Me kanë më të kuqë, m'i kishe gjetur, po kuqna unë që t'i lypa.

PO VDES

Një plak ishte sëmurë një natë bukur shumë. Kur e panë djemtë e tij, se më të vërtetë ishte keq, filluan të bisedonin njëri me tjetrin se si t'ia bënin, ku ta çonin. Njëri thoshte: ta çojmë në spital, tjetri thoshte: ta çojmë në ambulancë, tjetri thoshte: ta çojmë të një mjek privat.

Plaku i dëgjonte të gjithë djemtë e vet se si bisedonin për hallin e tij, por që nuk vendosnin asnjëri prej tyre se ku do ta çonin, kur e pa këtë plaku u ngrit nga shtrati duke iu drejtuar djemve me këto fjalë:

- A e dini çka bre djem, lëreni llafet krejt, se sonte po e kryej, po vdes.

DR. MEHMET RUKIQI

(Anekdotë)

BORXHI

Hasan <dervari ia jep do pare një t'Beçuksit,
për dy javë vade. U banë dy vjet e paret

kërkun! Nji ditë shkoj te dyert e borxhlië.

Doli e shoqja:

- Shka po doni?

- More, a po ma lani borxhin, që ma keni qe
dy vjet!

- Po, valla! Bash sot ka dalë burri n'bjeshkë,
me lypë cukla t'leshit që i kanë lanë dhentë
nëpër therra. Kur ta shet leshin, t'i jep paret!

Hasani, prej gazepit, ia nisë e po keshë – ha
ha ha..:

- Kesh bre kesh. Pse mos me keshë ti, masi
po t'lahet borxhi- ja ktheu fisnikja!

(Përzgjedhi: Imri A. Trena)



(Karikatura: Evgenij Načev, Bullgari)

Fabula nga Skender Demolli

BILBILI DHE PAPAGALLI

Atje në kopësht, mbi trëndafil,
U gjendën bashkë
Një papagall dhe një bilbil.
Bilbili s'priti
Edhe buçiti...
Pa dirigjent e violinë,
Ca këngë
Që magjepsin
Dhe vetë Perëndinë.
Po, kur pushoi,
Këngën e tij,
Si ta këndonte vetë përsëri,
Nga goja e papagallit e dëgjoi.
- Ua! Ua, - bëri çudi! –
Më thuaj, o mik
Cili Bilbil Gjyzar, na qënke ti?
Unë para teje,
Nuk paskam asnjë vlerë!...
Të lutem!
Të lutem!
Këndo të ta dëgjoj zërin dhe njëherë!
- Ah, të më dish, o vëlla, -
Psherëtin e fshin lotin
Papagalli te gjethja. -
Unë jam një bilbil i madh budalla,
Sepse nuk jam vetvetja!

THE NIGHTINGALE AND THE PARROT

There in the garden, on a rose,
They met together
A parrot and a nightingale.
The nightingale did not wait
And sang...
Without a conductor and a violin,
Some songs
That enchant
Even God himself.
And when he stopped,
How could he sing
His song
Again.
He heard it from the parrot's mouth
- Wow! Wow, - he was surprised! –
Tell me, friend
What kind of nightingale are you?
Before you
I have no value!...
Please!
Please!
Sing so I can hear your voice once more!
- Ah, I wish you knew me, -
The parrot sighed

And wiped a tear on a leaf. -

I am a big stupid nightingale,

Because I am not my own!

BILBILI DHE LEJLEKU

Kur i dëgjoi për herë të parë

Të këndojnë bretkosat,

Bilbili vriste mendjen,

Janë, apo s'janë shtatë, në muzikë notat.

- Kaq shumë, o bilbil

Kënga e tyre të preku, -

I tha, kur e pa te moçali leleku?

- Jo, - tha bilbili. - Rri e dëgjoj,

Po asnjë fjalë nga kënga e bretkosave,

Nuk po kuptoj!

Çfar thonë,

Që tërë ditën e ditës dhe natën nuk
pushojnë?

- “Ardhi vera! Ardhi vera! Ardhi
vera!”

Ku dinë ato fjalë të tjera?!

- Pse vetëm ato dy vallë?!

- Sepse sa më shohin mua, “gëk –
mëk”!

U ikën goja shtrembër e,

Nuk thonë dot më asnjë fjalë!

- Po ti, o lelek, vetë nuk këndon?

- Ah, veç të më dish!...

Zemra më pikon!

Dikur edhe unë, dija për të kënduar,

Po tani, o mik, vërtet kam harruar.

Dhe, e di përse:

Më thuaj me kë rri, të të them kush je!

Po të rrish këtu në moçal edhe pak

Dhe ty, o bilbil do të të këndojë bytha,

Si zhapjak.

Dhe që atëherë, për çudinë tonë,

Bilbilat heshtin dhe ikin në mal lart,

Kur fushave nisin bretkosat këndojnë.



(Karikatura: Nikolay Çernyshev, Rusi)

THE NIGHTINGALE AND THE SFORK

When he first heard

The frogs singing,

The nightingale wondered,

Are there, or are there not, seven notes in music.

- Has their song touched you

So much, nightingale –

He said, when he saw the stork in the swamp?

- No, - said the nightingale. – I sit and listen,

But not a word of the frogs' song,

I don't understand!

What do they say,

That they don't rest all day and night?

- "Summer has come! Summer has come! Summer has come!"

Where do they get other words from?!

-Why only those two words?!

- Because when they see me, "they make no sound!"

Not a whisper from those crooked lips and

They no longer utter a word!

- And you, oh stork, don't you sing yourself?

- Ah, if you only knew me!...

My heart is bleeding!

I too once knew how to sing.

But now, oh friend, I have truly forgotten.

And, you know why:

Tell me who you live with, and I will tell you who you are!

If you stay here in the swamp a little longer,

And you, nightingale, will sing like

A frog,

And from then on, to our surprise,

The nightingales fell silent and fled to the mountains above,

When the frogs began to sing in the fields.

L E J L E K U

D H E Z O G U I T I J

Dhe erdhi një ditë,

(rriten çilimijtë),

Ta nisë leleku për peshk të birë.

- Te Pellgu i Bretkosave, - i thotë. –

Po, i mat forcat mirë!

Cironj të vegjël gëlltit

E, bretkut të madh

Ca kohë mos iu avit.

Por... Veç të ishit

Edhe të shihnit, ç'i panë sytë,

Kur bretku i madh,

Me kokën brenda, në sqep të lelekut,

E kapi për fyti e desh ta mbytë!


- Lere të lirë, -

I thërret plaku me habi!

- Baba!...

Tani e lëshoj unë,

Po, nuk më lëshon ai!



(Karikatura: Ivan Turuçko, Ukrainë)

Është e pamundur! E pa mundur!

- Lëpije atëherë!... Lëpije!

Mënyra më e mirë të shpëtosh nga një luftë
është,

Tërhiq sa më parë prej saj i humbur!

THE STORK AND HIS STORKLING

And day she came,

(the storlings are growing),

The stork set out for free fish.

- To the Frog Pond, and says to her, -

So, if you measure your strength well!

You'll swallow small young fish

And don't go near

The big frog.

But if you had only been

And seen, what her eyes saw,

When the big frog,

With its head inside, in the beak of the stork,

Grabbed her by the throat and wanted to
strangle her!

- Let him go, -

The old one calls out in surprise!

- Father!...

I'll let him go now,

But he won't let me go!

It's impossible! It is impossible!

- Lick him then!...Lick!

The best way to escape a fight is,

Retreat from it as soon as possible as a
loser!



(Karikatura: Aleksei Kivokurtcev, Rusi)

Përktheu: Fadil Bajraj

Opinione për librat pa moshë e pa kohë

MURROSH PUSHI DEMBELUSHI

“Murrosh Pushi Dembelushi”, një poemë e ndërtuar si një univers poetik për fëmijë, ku përthuren tradita e përrallës shqiptare me një frymë moderne, lojcake dhe edukative


- Shënime për poemën “Murrosh Pushi Dembelushi” (krijim i ri mbi një motiv të vjetër), autore: Adelina R. Mamaqi, redaktore: Ilirjana Jaku, ilustrimet: Blegina Hasko Bezo, Botimet "Univers", Tiranë, nëntor 2025- Nga Xhahid Bushati



Në vend të përfundimit: Poema humoristike “Murrosh Pushi Dembelushi” e Adelina R. Mamaqit përfaqëson një ndër arritjet më përfaqësuese të letërsisë bashkëkohore shqiptare për fëmijë. Vepra ndërtohet mbi traditën e përrallës dhe të poemës narrative, duke e rinovuar atë përmes një strukture ciklike, të një gjuhe ritmike dhe të një këndvështrimi psikologjik të thellë mbi botën

fëmijërore. Mamaqi ndërthur elemente të folklorit, fabulës klasike dhe poetikës moderne, duke krijuar një univers letrar ku edukimi realizohet përmes humorit, empatisë dhe fantazisë. Në qendër të poemës qëndron motivi i dembelizmit, i njohur gjerësisht në folklorin shqiptar dhe në letërsinë botërore për fëmijë. Figura e personazhit pasiv, që shmanget veprimin dhe përgjegjësinë, shërben tradicionalisht si objekt satire dhe qortimi moral. Mamaqi e rimerr këtë motiv duke e zhvendosur nga moralizimi i drejtpërdrejtë drejt një leximi empatik. Murroshi nuk dënohet, por kuptohet si produkt i një bote fëmijërore të mbrojtur dhe të përkëdhelur. Murrosh Pushi është një personazh kompleks, që përfaqëson fëmijën në fazën e tij të hershme të zhvillimit. Qëndrimi i tij “brenda” nuk është thjesht fizik, por simbolizon: - hapësirën e sigurisë emocionale; - refuzimin e përkohshëm të botës së jashtme; nevojën për lojë, gjumë dhe fantazi. Pjesë si “Kush bën nina-nana” dhe “Nënë Lepurusha ushqen zogjtë” ndërtojnë një diskurs të fortë të kujdesit prej amësie. Autorja afirmon idenë se rritja nuk realizohet përmes presionit, por përmes dashurisë dhe mirëkuptimit. Ndërsa të “Përralla shkoi te Magjistaria” dhe “Përralla hyn në pyll”, përralla personifikohet, duke u shndërruar në subjekt aktiv. Kjo teknikë i jep veprës një


dimension metatekstual: vetë rrëfimi bëhet personazh. Kurse te pjesët: “Janë tre vëllezër”, “Gjyshi plaku lepuraku” dhe “Bën karroca shtrik e shtrak” mbështeten në formulat tradicionale të oralitetit (numri tre, rimëzimi, përsëritja), duke ruajtur lidhjen me trashëgiminë kulturore. Mjedisi ku veprojnë personazhet është i ndërtuar sipas parimeve të antropomorfizmit. Pisha që flet, lepur i që kujdeset për zogjtë, ketrushi që guxon, krijojnë një ekosistem moral, ku natyra është bashkëedukatore e fëmijës. Loja është elementi themelor i strukturës semantike të poemës. Ky proces përfaqëson një model modern të edukimit letrar për fëmijë.



* * * Letërsia për fëmijë, sipas Bruno Bettelheim-it, nuk ka për funksion vetëm argëtimin, por ndihmën që i jep fëmijës për të kuptuar konfliktet e brendshme dhe procesin e rritjes. Në këtë kuadër, poema “Murrosh Pushi Dembelushi” ndërtohet si një hapësirë simbolike, ku konflikti nuk është i jashtëm (luftë, rrezik, ndëshkim), por psikologjik dhe emocional: hezitimi për të dalë nga zona e sigurisë. Adelina R. Mamaqi e përdor përrallën jo si fabul morale klasike, por si mekanizëm zhvillimi të vetëdijes fëmijërore, duke e afruar veprën me konceptet moderne të kritikës së letërsisë për fëmijë. Kurse Vladimir Propp, te “Morfologjia e përrallës”, e sheh përrallën si sistem funksionesh. Në poemën e Mamaqit: - Murroshi nuk e përmbush menjëherë funksionin e heroit; - mungon “nisja” klasike e personazhit; - zëvendësohet nga shtyrja e veprimit. Kjo përbën një devijim modern nga skema tradicionale, ku mosveprimi bëhet vetë funksion narrativ. Dembelizmi nuk është mungesë vlere, por fazë përgatitore. Sipas Bettelheim-it, përrallat funksionojnë sepse legjitimojnë frikërat dhe pasiguritë e fëmijës. Murroshi: - rri brenda → i mbrojtjes; - refuzon jashtë → frikë nga pavarësia; loz me jastëkë → kanalizim i energjisë agresive në lojë. Në këtë kuptim, Murroshi nuk është “dembel”, por në proces formimi. Autorja

shmang ndëshkimin, duke ofruar një model edukativ jo represiv. Në pjesë si “Përralla shkoi te Magjistarja” dhe “Ç’u bë përralla, kush e pa?”, kemi një rast të qartë të metapërrallës: përralla bëhet personazh; - rrëfimi flet për vetveten. Sipas Perry Nodelman-it, kjo teknikë i jep fëmijës vetëdije për procesin e tregimit, duke e bërë atë bashkëkrijues të kuptimit, jo konsumator pasiv. Poema është ndërtuar si cikël i hapur, ku episodet: - janë të pavarura; - por kontribuojnë në zhvillimin e personazhit. Përsëritja e motiveve (gjumi, loja, kafshët, të qarat) funksionon si: - mekanizëm qetësues; - mënyrë për të ndërtuar siguri emocionale. Kjo lidhet me teorinë e oralitetit dhe me funksionin ritmik të poezisë për fëmijë. Sipas traditës së fabulës dhe përrallës: - kafshët mbartin vlera njerëzore. Te Mamaqi, në pjesë si: - “Nëna lepurushë ushqen zogjtë”, “Ç’po u thotë pisha zborakeve” antropomorfizmi shndërrohet në etikë të solidaritetit universal. Nuk kemi hierarki të forta, por ndihmë reciproke, çka e afron veprën me një vizion ekologjik dhe humanist modern. Perry Nodelman thekson se loja në letërsinë për fëmijë është formë njohjeje e botës. Në episode si: - “Me jastëkë bam e bum”, “Ketrush Parashuta” loja: - zëvendëson veprimin “serioz”; - përgatit Murroshin për guximin real. Kështu, loja nuk i kundërvihet

punës, por i paraprin asaj. Stili i Mamaqit përfaqëson atë që kritika moderne e quan realizëm emocional. Ky realizëm e bën veprën të besueshme për fëmijën dhe të vlefshme për mësuesin dhe edukatorin. Në krahasim me poezinë tradicionale për fëmijë në letërsinë shqipe, kjo poemë: - zgjeron format narrative; - shmang moralizimin frontal; - fut dimensionin psikologjik dhe metatekstual.



Mamaqi sjell një model të ri: përrallën si hapësirë dialogu me fëmijën, si dhe konsiston në faktin se ajo: - njeh fazat emocionale të rritjes; - i përkthen ato në gjuhë poetike; - ndërton një univers ku fëmija ndihet i jetueshëm. “Murrosh Pushi Dembelushi” nuk është thjesht poemë humoristike, por tekst formues, që ndërthur traditën, teorinë dhe ndjeshmërinë moderne të letërsisë për fëmijë.

* * * Krahas cilësisë artistike që është kryesorja, libri artistik i letërsisë për fëmijë ka edhe komponentë të tjerë që e

përfaqësojnë që ai të jetë dinjitoz. Libri është i tillë dhe mbart brenda vetes estetikën feminare. Sh. B. "UNIVERS" i ka kushtuar vëmendje dhe kujdesin e duhur: që nga letra, që nga formati, që nga arti grafik dhe ilustrimet e mrekullueshme, plot magji e fantazi përrallore dhe funksionale (të tekstit poetik) të piktores Blegina Bezo. Një libër që e ëndërron ta ketë çdo krijues!

Shkodër, më, 25.12.2025



Karikatura: Silvano Melo, Brazil

KËSHILA MJEKËSORE PËR MOSHËN MADHORE


Jemi në një moshë shumë elegante. Praktikisht kemi gjithçka që kemi dashur 70 vjet më parë: nuk shkojmë më në shkollë apo punë, kemi një pagesë mujore dhe strehim të mirë. Nuk kemi pse të kthehemi pas në kohë. Disa kanë leje drejtimi dhe madje edhe makinë. Kështu që jeta është e bukur! Gjithashtu: Ne jemi tepër të zgjuar! Truri ynë është më i ngadalshëm sepse është i mbingarkuar me njohuri. Ne nuk jemi aspak budallenj, thjesht duhet të kërkojmë më fort për faktet e nevojshme mes tonelatave të njohurive dhe përvojës. Në kokën tonë janë grumbulluar shumë gjëra të cilat ndër të tjera bëjnë presion edhe në veshin e brendshëm, prandaj ndonjëherë kemi probleme me dëgjimin. Është njësoj si hard disku i kompjuterit që ngadalësohet sepse është plot me skedarë. Truri ynë nuk është më i dobët, por ka grumbulluar shumë më tepër informacion. Te tjeret thonë se njerëzit e moshës sonë shpesh hyjnë në dhomë dhe nuk kujtojnë se çfarë donin me të vërtetë, ose ne nuk mbajmë mend se ku kemi vendosur diçka. Nuk është problem memorie! Natyra na detyron të vazhdojmë të lëvizim edhe pak.

PËR TË GJITHË MBI 60: Ushqimi i kërkuar: 1. Perimet, frutat 2. Bishtajoret 3. Arra 4. vezë 5. Peshk, mish (disa herë në javë) 6. Vaj

Tre gjëra për të harruar: 1. Moshë 2. E kaluara 3. Ankesat

Tre gjëra të rëndësishme: 1. Miqtë 2. Mendimet pozitive 3. Një shtëpi e qetë dhe mikpritëse. Veprimet më të dobishme: 1. Buzëqeshni dhe qeshni shumë! 2. Stërvituni, por vetëm me ritmin tuaj 3. Kaloni më shumë

kohë me miqtë (jo gjithmonë vetëm me prindërit, fëmijët apo nipërit, por edhe me miqtë).



Shtatë gjëra thelbësore: 1. Mos prisni derisa të keni etje për të pirë ujë. Pini më shpesh. 2. Mos prisni derisa të jeni të përgjumur për të fjetur, flini mjaftueshëm 3. Mos prisni derisa të jeni të lodhur për të pushuar. 4. Mos prisni derisa të sëmureni për të parë një mjek. Shkoni te mjeku rregullisht! 5. Mos prisni mrekulli hyjnore! 6. Mos e humb kurrë besimin! 7. Qëndroni pozitiv dhe gjithmonë shpresoni për më të mirën!

“Kam numëruar vitet e mia dhe kam zbuluar se nga këtu e tutje do të më mbetet më pak kohë për të jetuar sesa kam jetuar tashmë. Ndihehem si ai fëmija që fitoi një paketë ëmbëlsirash dhe i hëngri shpejt të parat, por kur kuptoi se kishin mbetur vetëm pak, filloi t'i shijonte në qetësi të plotë. Tani nuk kam kohë për takime pa fund, ku diskutojmë statutet, rregulloret, procedurat dhe rregulloret e brendshme, duke e ditur se asgjë

nuk do të arrihet... Tani nuk kam kohë të duroj njerëz absurdë që pavarësisht moshës nuk janë rritur. Nuk kam më kohë për mediokritet. Nuk dua të marr pjesë në mbledhje ku parakalojnë njerëz të fryrë nga egoja. Nuk i duroj dot manipuluesit dhe oportunistët. Më bezdisin njerëzit ziliqarë që përpiqen të diskreditojnë ata që janë më të aftë, zënë vendin e tyre, talentin dhe rezultatet e tyre. I urrej, nëse vë re, defektet që gjeneron lufta për poste të mëdha. Njerëzit nuk e diskutojnë përmbajtjen, por titujt. Koha ime është shumë e kufizuar për të diskutuar aksionet. Unë e dua thelbin, shpirti im është në nxitim... Pa shumë ëmbëlsira në paketim... Unë dua të jetoj pranë njerëzve njerëzorë, shumë njerëzorë. Kush di të buzëqeshë me gabimet e tyre. Mos u kreno me fitoret. E cila nuk konsiderohet e zgjedhur, edhe para se të zgjidhet. Mos e lini të shpëtojë nga përgjegjësitë e tij. Ata që mbrojnë dinjitetin njerëzor dhe ata që duan të jenë vetëm në anën e së vërtetës dhe ndershmërisë. Thelbësore është ajo që e bën jetën të vlefshme. Dua të rrethohem me njerëz që dinë të prekin zemrat e njerëzve... Njerëz që kanë mësuar nga goditjet e forta të jetës të rriten me prekje delikate në shpirt. Po... nxitoj... të jetoj me intensitetin që mund të japë vetëm pjekuria. Nuk dua të humb as një karamelë që më ka mbetur... Jam i sigurt se do të jenë më të shijshme se çdo gjë që kam ngrënë ndonjëherë. Qëllimi im është të arrij në fund i kënaqur dhe në paqe me të dashurit e mi dhe me ndërgjegjën time. Shpresoj që të jetë edhe e juaja, sepse në një mënyrë ose në një tjetër do të arrini atje...

MARIO Andrate

KARTOLINA E NJË ARTISTI NGASHQIPËRIA



Aktori i njohur Albano Bogdo ka reaguar ashpër ndaj situatës sociale dhe ekonomike në vend, duke akuzuar politikën për dështim dhe artistët për heshtje e servilizëm. Gjatë një deklarate në emisionin “Quo Vadis” në Vizion Plus, Bogdo u shpreh se Shqipëria, ndonëse është një nga vendet me më shumë burime natyrore në Europë, vazhdon të ketë qytetarë që vuajnë për nevojat bazë. “Ne futemi në 10 vendet me më shumë ujë për frymë, por asnjë familje nuk ka ujë 24 orë. Mund të kishim dhjetëra hidrocentrale dhe energjinë ta kishim falas, ndërsa sot fatura e dritave është makthi më i madh

për familjet shqiptare”, tha ai. Sipas Bogdos, përgjegjësia është e politikës, e cila ndër vite nuk ka arritur t’u garantojë qytetarëve shërbimet bazë. “Nafta jonë vidhet prej dekadash, që nga koha e Ismail Qemalit e deri sot. Askush nuk e rregulloi këtë vend që njerëzit të kishin ujë, drita dhe naftë të lirë. Ne i kemi, por i paguajmë më shtrenjtë se kushdo tjetër në Europë”, u shpreh aktori. Kritika të forta ai pati edhe për komunitetin e artistëve, të cilët i akuzoi për heshtje dhe mungesë guximi. “Artistët janë një m*t i madh. Të gjithë gënjejnë, të gjithë janë të blerë. Ulin kokën nga frika e pronarëve të medieve dhe nuk e thonë të vërtetën. Kjo është kartolina ime për Vitin e Ri”, tha Bogdo.



NDAHET NGA JETA KARIKATURISTI NGA
BOSNJA E HERCEGOVINA, RESHAD
SULLTANOVIQ (1955 – 2025)



Reshad Sulltanoviq është i lindur në vitin 1955 në Kladanj.

Si pjesëmarrës dhe dëshmitar i kohërave më të vështira, ai dha kontribut të pamatshëm në mbrojtjen e vendit dhe popullit të vet, dhe është përfitues i çmimit më të lartë komunal, Stemës së Artë për Kontribut në Mbrojtjen e Bosnjës e Hercegovinës.

Ishte anëtar i rregullt i Shoqatës së Arteve të Bukura dhe Arteve të Aplikuara të Bosnjës e Hercegovinës, Shoqatës Kroate të Karikaturistëve dhe anëtar i Shoqatës së “Karikaturistëve” Ilidža.

Ai ia kushtoi më shumë se katër dekada karikaturës, shprehjes artistike përmes së

cilës e përshkruante botën përreth me shpirt dhe ironi të madhe.

Mori pjesë në mbi 600 festivale në botë, fitoi më shumë se 30 çmime ndërkombëtare dhe rreth 100 mirënjohje, dhe në shumë raste ishte përfaqësuesi i vetëm i Bosnje-Hercegovinës.

Karikaturat e tij ishin pasqyrë e realitetit, por edhe protestës. Ishte i buzëqeshur por thellësisht i menduar, i njohur nga humori i veçantë dhe mendimi i mprehtë por fisnik. Puna dhe shpirti i tij tejkaluan kufijtë, dhe buzëqeshja, ngrohtësia dhe komenti i tij i zgjuar e bënë atë të preferuar mes miqve dhe kolegëve.


Në çdo gjë që bënte, vizatonte, fliste, Reshadi ishte i singertë, i përkushtuar dhe vetvetja. Ishte njeri që dinte të bashkonte seriozitetin e jetës dhe lehtësinë e të qeshurit, që dinte të gjente një kokërr mirësie dhe frymëzimi në çdo situatë.

Ai pat thënë: **“Karikatura është revolta ime kundër realitetit - por edhe buzëqeshja ime pavarësisht saj.”**


Reshad Sulltanoviq, ishte pjesëmarrës i rregullt në Festivalin Ndërkombëtar të Karikaturës që e organizon HiTHi Kosova Cartoon në Ferizaj dhe përherë u kualifikua. Karikaturat e tij ka pasur rastin t’i shohë e t’i shijoj edhe publiku ferizajas, me përjashtim të edicionin të fundit (për shkak të gjendjes shëndetësore jo të mirë).

Vitin e kaluar, me disa shokë ishim në një konferencë ndërkombëtare në Sarajevë dhe më parë u morëm vesh të takoheshim, por, ditën kur isha në Sarajevë, ai ishte në spital duke i bërë disa analiza dhe më luti të qëndroja edhe një ditë, por fatkeqësisht, për të njëjtën ditë e kishim rezervuar fluturimin për në Zagreb.

Tani Bosnja e Hercegovina e ka një karikaturist më pak, Festivali i Karikaturës në Ferizaj do ta ketë një karikaturist më pak dhe ne të gjithë artdashësit – karikaturistë, do ta kemi një mik më pak, por karikaturat e tij mbeten në katalogët tanë, që ta kujtojmë përherë.



Resad Sultanovic, Bosnia and Herzegovina
Pjesëmarrës / Participants



(Karikaturat: Reshad Sulltanoviq, Bosnjë e Hercegovina)

Imri Musliu
MBRESA NGA UDHËTIMI
NË EGJIPT (3)

Këtë herë, me propozimit e mikut tonë karikaturist nga Egjipti Fawzy Morsy, na është dërguar ftesë zyrtare që ne të jemi mysafirë me rastin e hapjes së këtij festivali, kjo falë bashkëpunimit tonë të gjatë mbi një dekadë me Fawzi Morsin i cili është drejtor i “Egypt Cartoon”. Në një nga numrat e Revistës Satirike... “HiTHi Qesh” është prezentuar karikatura egjiptiane, përmes një shkrimi të Fawzi Morsit.

U zgjuam me zile në orën tetë të mëngjesit. Para se të futeshim në restorant, i bëmë disa fotografi, se vërtetë ngjyrat e luleve na tërhiqnin më shumë se ushqimi, i cili doli të

ishte mjaft i shijshëm dhe i përgatitur me kujdes nga kuzhina e traditës egjiptiane.



Më pas u nisëm drejt Qendrës së Artit Abla, ku pritej të tuboheshin të gjithë pjesëmarrësit, pikërisht në orën 11,00. Distanca deri atje ishte një kilometër e gjysmë, por vendosëm të shkonim këmbë ta eksploronim edhe një pjesë të fshatit turistik Tunis.

Rrugës

Rruës deri tek vendi ku mbahej festivali, pamë shumëçka interesante. Burra me fustanë deri në fund të këmbëve, fëmijë që loznin zbathur, kuaj e shumëçka. Diku vërejtëm misër të gjelbërt që kishte lidhur tramak, një arë më tutje me misër që sa kishte mbirë, grumbuj gurësh që sigurisht ishin aty për ndonjë ndërtim që priste të realizohej së shpejti, një kanal uji që i

ngjante një përrocke, një mur oborri me një dizajn interesant dhe i ndërtuar i tëri prej dheu (çudi si nuk ishte dëmtuar nga reshjet), por dheu i tokës më bëri më shumë përshtypje me ngjyrën e tij të verdhë dhe ishte aq i butë e i përshtatshëm për të ecur zbathur.



Shkëmbimi i katalogjeve me organizatorin



Aty ku po përgatitej ekspozita, shkuam para kohe, kur mysafirët tjerë ende nuk kishin

ardhur, dhe kjo na krijoi një përpasrësi, se folëm e u njohëm me të gjithë organizatorët, kur aty nuk kishte mysafirë tjerë dhe morëm shumë informata që mund të na hynin në punë më vonë. Derisa vullnetarët punonin rreth përgatitjes së ekspozitës e cila bëhej në ambient të hapur, ne na e rezervuan një tavolinë nën një hije të freskët, mbi dheun e verdhë, ku na shërbyen me kafë e ujë. Hapësira ishte aq e gjërë, sa krijohej përshtypja se e gjithë bota e artit mund të prezentohej aty pa më të voglin problem.



Më pas u duk edhe miku ynë Fawzi Morsy, i cili erdhi bashkë me shumë artistë nga Kairoja, me tre autobusë, të përcjellur me masa të shumta sigurie. E gjithë hapësira ishte siguruar me forca sigurie, të cilët mbanin edhe armë. Mendova se këto masa merren për shkak të shumë ambasadorëve të shteteve që do të merrnin pjesë në hapje, por më pas e kuptova se kjo bëhej edhe për sigurimin e karikaturistëve, se vërtetë karikaturistët janë në shënjestër, thuaja

njëjtë si reporterët nga zonat e luftës. Kjo bindje m'u forcua edhe më, kur m'u kujtua, se një mik karikaturist i cili vite më parë kishte marrë pjesë në një festival të karikaturës në Francë, më kishte thënë se për shkaqe sigurie organizatori kishte siguruar një anije ku do të flinin karikaturistët, për të mos u ndodhur ndonjë e papritur.



Aktiviteti zgjati deri në mbrëmje

Mendova se në orën e paraparë 11.00 do të bëhej hapja e ekspozitës, por organizatori kishte paraparë agjentë tjetër.



Së pari u njoftuan mysafirët në mes vete, pa protokoll. Edhe ne patëm rastin, që përveç artistëve t'i takojmë edhe katër ambasadorë të shteteve nga Evropa dhe Amerika Latine dhe i njoftuam për shkurt për aktivitetin e HiTHi Kosova Cartoon, bëmë fotografi me ta dhe u dhuruam katalogje, revistën HiTHi Qesh e ndonjë fletëpalosje nga aktivitetet tona në Ferizaj e gjetiu, por më e rëndësishmja është ajo që ia dhuruam Muzeut të Karikaturës në Fayoum Art

Center, e që është Muzeu i parë i Karikaturës në Lindjen e Mesme! Me aktin e dhurimit të materialeve për këtë muze, kishim për qëllim që bota e karikaturës, jo vetëm nga Egjipti, por edhe nga vendet tjera jashtë Afrikës, të njihen me krijuesit e karikaturës që veprojnë në Kosovë e Shqipëri. Vetëm në një katalog nga një ekspozitë në Ferizaj janë përfshirë 23 karikaturistë nga Kosova e Shqipëria, me biografi, fotografi, dhe me një apo dy karikatura për secilin. Me këtë rast, Cicëronja e muzeut na njoftoi gjërësisht për të gjitha materialet që ndodheshin në kthinat e muzeut, që nga jashtë dukej i vogël, por me të hyrë brenda, u pa se ishte mjaft i madh si hapësirë por edhe i pasur me materiale, të rregulluara nga një dorë profesionisti me përvojë.

Ushqimi për mysafirët



Në një hapësirë të gjërë të gjelbëruar e me lule shumëngjyrëshe, ishin vendosur tavolina e karrige, që i ngjante një dasmë

mbretërore, dhe vërtetë, a ka dasmë më të madhe se dasma e karikaturës, ku përveç artistëve nga shumë vende të botës, kishte edhe diplomatë e ambasadorë shtetesh të ndryshe? Vetëm Kosova nuk kishte përfaqësues diplomatik, edhe pse i kemi bërë kërkesë për një takim, Shefit të Misionit të Zyrës Përfaqësuese të Kosovës në Kairo, por nuk kemi marrë përgjigje!



Me ambasadoren e Sllovakisë në Kairo

Para se të fillonte ceremonia e çmimeve, në karriget e para ishin vendosur letra me emrat e mysafirëve të ftuar, ku secili duhej të ulej në vendin e vet, kurse në qendër të rreshtit të pare ishte rezervuar karrigia për themeluesin e Fayoum Art Center z. Abla...

Procedura e ndarjes së çmimeve shkoi për mrekulli. Ajo që më bëri përshtypje, ishte se përveç kameramanëve e fotografëve të ftuar,

kishte interesim të madh për të bërë video e fotografi nga shumë njerëz të vullnetit të mirë dhe gjithçka shkoi spontanisht, dhe pa u ngutur.



Gjatë intonimit të himnit të Egjiptit



Me karikaturistin nga Egjipti, Mahmoud
Abd Al Wahab

Me të filluar të binte terri, nën përcjelljen
organeve të sigurisë, me tre autobusë, u
nisëm për në Kairo.

Me të arritur, bëmë një shëtitje natën, me
miqët tanë artistë nga Egjipti, dhe një
gazetari e një gazetareje, deri në orët e vona
të natës.

Darkuam bashkë dhe mëpas në një lokal ku
shërbenin nën qiellin e hapur, pimë çaj të
gjithë bashkë, për të vazhduar 20 km. nga
aty, deri tek Jasmin Pyramids Hotel.



Me njërin nga organizatorët, z. Ibrahim
Ablla

I lodhur nga aktiviteti ditë dhe shëtitja në
mbrëmje vonë në qytet me miqtë egjiptianë,
u mundova t'ua kthej mesazhet miqëve të
shumtë, që më kishin shkruar gjatë ditës, me
një lidhje interneti të dobët, dhe u shtrina në
shtrat, tek pas orës 2.30 të pasmesnatës për
të vazhduar të nesërmen vizitën në piramidat
e Gizës.

Intervistë me redaktorin e parë të librave nga Kosova që u botuan në Shqipëri, në kohën e "Perdes së Hekurt", shkrimtarin e poetin Pandeli Koçi.

KOHËT E REJA KANË NEVOJË PËR STILE TË REJA



Bisedë e shkrimtarit Kozma Gjini me shkrimtarin Pandeli Koçi (Sazan Goliku)
Pyetje: Zoti Pandeli, se pari ju uroj 80-vjetorin e ditëlindjes! Ju jeni një shkrimtar shumë i njohur në shkallë vendi me botimet në letërsinë për të rritur e për fëmijë po dhe në shkrimet e shumta që keni publikuar me kritika letrare dhe intervistat në televizionet kombëtare, si pedagog e gazetar. Ju keni një

jetë që i jeni kushtuar letërsisë. Keni një përvojë të vyer si punonjës në institucionet shtetërore, po kaq shumë i angazhuar në letërsi. Si e ndien veten shkrimtari Pandeli Koçi në prag të 80-vjetorit të ditëlindjes? A jeni i plotësuar me gjithçka keni botuar deri tani? Përgjigje: Ende nuk e ndiej veten plak, por jam i pakënaqur se nuk i kam jetësuar ato që kam ëndërruar se do të arrija t'i shkruaja. Pyetje: Ju njiheni e shkruani me emrin letrar "Sazan Goliku". A ka një arsye që ju është dashur të përdorni edhe pseudonimin? Përgjigje: Nuk ka asnjë arsye ose shkak. Siç e thatë dhe ju, ky është një emër letrar dhe jo pseudonim (emër i rremë). Përdorimi i një emri letrar njihet në historinë e letërsisë dhe të artit deri në ditët tona. Kjo dukuri as e ngre as e ul vlerën artistike të veprës së krijuesit. Për mua ka qenë një tekë rinore, ndoshta për të imituar shkrimtarë të njohur shqiptarë dhe të huaj si Mark Tueini dhe Migjeni etj. Pyetje: Arti juaj, si në prozë ashtu dhe në poezi, karakterizohet nga lakonizmi. Ju nuk rendni drejt faqeve të shumta. Cilat janë avantazhet e të shkruarit kështu? Përgjigje: Çështje stili e autorit dhe parapëlqim i lexuesit. Nuk kurrfarë avantazhesh; ka rreziqe se mund të biesh në proleksitet kur shkruan gjatë dhe mund të biesh në cerebralitet kur shkruan shkurt. Pyetje: Ju keni qenë edhe pedagog, keni dhënë leksione

në universitetin e Tiranës në kursin special për letërsinë e Kosovës. Sa ndikoi ky kurs për njohjen e kësaj pjese të letërsisë shqipe nga studentët? Përgjigje: Edhe një qiri të ndriçon në errësirë. Ishte caktuar që leksionet t'i jepja një herë në javë, ditën e hënë me studentët e vitit të katërt të gjuhë-letërsisë shqipe. Që nga viti 1971 ishin lejuar të botoheshin libra nga Kosova, po këta ishin të paktë dhe të kontrolluar. Unë lëvdohem që kam qenë i pari, i cili redaktoi e përgatiti për shtyp librat me poezi nga Kosova, po dhe romane, drama e letërsi për fëmijë. Pyetje: Pra, keni një njohje më të thellë për letërsinë e Kosovës. Cili është sot niveli i letërsisë së Kosovës? Përgjigje: Si niveli i gjithë letërsisë shqipe në të dy anët e kufirit shqiptaro-shqiptar dhe në ngulimet shqiptare në botë. Pyetje: A mund të kemi një mekanizëm, forum përbashkues, që letërsitë e dy shteteve tona të mund të promovojnë artin e kulturat si një të vetme? Kjo do të ishte një premisë afatgjatë që do t'i printe bashkimit të dy vendeve. Si mendoni ju? Përgjigje: Letërsia shqipe është një e vetme kudo dhe cilido që shkruan shqip, pavarësisht ndryshimeve në botën që pasqyron, në dialektin ose nën dialektin që përdor, në parapëlqimet stilistikore, në metodat ose drejtimit letrare. Akademitë dhe institutet tona kanë ura e mundësi komunikimi e bashkëpunimi. Perspektiva

historike mes hapësirave shqiptare është e pashmangshme. Pyetje: Historikisht, libri i ka rezistuar rrebesheve të zhbërjes, por sot atë po e konkuron teknologjia virtuale që po ecën me ritme gjigande dhe po e nëpërkëmbë librin fizik. Cili është mendimi juaj për të ardhmen? Përgjigje: Zhvillimet e shkencës e të teknologjisë historikisht kanë buruar nga librat. Unë nuk shoh konkurrencë mes tyre. Leximi në gur, në pergamen, në letër ose në kompjutër e kindëll është lexim, studim që e ka çuar më përpara shoqërinë njerëzore. Libri fizik dhe libri dixhital janë vazhdim dialektik i njëri tjetrit. Ne që jemi mësuar, si paraardhësit tanë, me letrën, e kemi të vështirë të pranojmë ndryshimin, jemi besnikë të librit tradicional. Dhe kjo do të vazhdojë për një kohë të gjatë. Që në kohën tonë shumë njerëz nuk përdorin më lapsin ose stilografin, por shkruajnë vetëm në PC. Duam apo nuk duam ne kjo është dukuri universal e së ardhmes. Pyetje: Në faqet letrare të disa organeve të shtypit shkruhet në të dy dialektet, pra, jo në gjuhën letrare të miratuar nga Kongresi i Drejtshkrimit. Aktualisht nuk ka një akt përfaqësimi kombëtar që ta përjashtojë Kongresin edhe pse ai u bë në diktaturë. A keni ju një mendim ndryshe për këtë dukuri? Përgjigje: Gjuha shqipe standarde është një arritje madhe popullit shqiptar, e shtetit dhe kombit tonë.

Përdorimi i saj në institucionet shtetërore, në institucionet arsimore etj. është një detyrim ligjor. Nuk ka asnjë ndalim përdorimi në familje dhe në shoqëri. Në krijimtarinë letrare çdo autor përdor në shkrimet e librat e tij edhe dialektin ose nëndialektin përkatës dhe askush nuk e ka ndaluar. Pyetje: Ka një numër të madh përkthimesh të librave të nobelistëve, të shkrimtarëve të traditës e bashkëkohorë botërorë që ribotohen te ne për çdo vit. Mos po e konkuron tregun e librit botimi i autorëve të huaj? Përgjigje: Po, e konkurren. Është detyrë atdhetare e botuesve dhe e institucioneve përkatëse shtetërore të investojnë për letërsinë shqipe, për të arritur atë që na këshillon Faik Konica: Duhet të botojmë 50% letërsi shqipe dhe 50% letërsi të huaj. Pyetje: Cili është vendi dhe roli i kritikës letrare në Shqipëri? Kritika profesioniste sot nuk ekziston. Si do shkojë fati i kritikës letrare në të ardhmen? Përgjigje: Dihet që kritika letrare është mbështetëse e letërsisë. Me analizat e vlerësimet e saj për krijimtarinë artistike dhe dukuritë letrare, ajo krijon hierarkinë e vlerave dhe kundërvlerave, spikat të bukurën nga banalja e mediokriteti. Edhe te ne kritika ka bërë deri diku përgjithësimet e vlerësime objektive, por zig-zaket e saj janë kushtëzuar nga një sërë si faktorësh, si mungesa e fakulteteve ose kurseve të posaçme për përgatitjen teorike

dhe estetike, mungesa e gatishmërisë për të lejuar shprehjen e mendimit pa kompromis, dalja e një reviste ku do të pasqyrhej mendimi kritik. Pyetje: Cili është mendimi juaj për vendin që zë letërsia shqipe në tryezën e simotrave europiane apo dhe botërore? Përgjigje: Pak, shumë pak. Dhe kjo shpjegohet jo aq me nivelin e saj artistik, po me problemin e njohjes, mungesën e përkthimit me nivel të veprave shqipe në gjuhët e mëdha. Janë bërë disa nisma nga Ministria e Kulturës, për të nxitur përkthimet nga shqipja në gjuhë të huaja, por kërkohet vijëmsi e pandërprerë. Pyetje: Cili është sipas jush raporti i modernes me tradicionalen në letërsi? Përgjigje: Nuk mund të flitet për raporte apriori mes tradicionales e modernes, sepse ato ekzistojnë së bashku në të njëjtën kohë, madje edhe te një shkrimtar. Është cilësia artistike e një krijimi letrar, qoftë tradicional ose modern, që përcakton vlerën e vërtetë. Pyetje: Ka libra të huaj dhe të “autorëve” vendas, që personazhet hyjnë e dalin dhe bëjnë llojet e seksit, sikur jeta qënka vetëm seks (!?) Cili është qëndrimi juaj rreth këtij problemi? Përgjigje: Librat komercialë, pornografikë ose rozë kanë qenë botuar dhe botohen ende në botë. Edhe te ne pas vitit '90 nisën të botohen libra të tillë, po me kohë sikur kanë rreshtur, edhe pse ende mund të gjeshë në “bux trotuar” po dhe në librari

serioze. Por lexuesit me nivel kulturor nuk i afrohen kësaj letërsie banale ose pa vlera artistike. Pyetje: Shkrimtari ynë i shquar Ismail Kadare ka qënë disa herë në prag për çmimin “Nobel”. Organizma letrarë dhe personalitete letrare botërore kanë sugjeruar me shkrim mbështetjen për dhënien e këtij çmimi. Nga ana tjetër, disa individë shqiptarë, kanë bërë të kundërtën. Cili është opinionimi juaj për këtë problem? Përgjigje: Kadareja ka fituar disa çmime të rëndësishme me famë botërore. Vepra e tij nderon letërsinë dhe gjuhën tonë. Ne jemi krenarë si shqiptarë që kemi një gjigant të tillë në fushën e artit letrar. Dhënia ose jo e çmimit “Nobel” nuk ka të bëjë me madhësinë e Kadaresë. Është problem i jurisë së “Nobelit” që është infektuar nga disa keqdashës, shpirtvegjël dhe zilarësh fatkeq. Pyetje: Ju keni drejtuar për një periudhë Shoqatën Kombëtare të Shkrimtarëve të Letërsisë për Fëmijë e të Rinj. Cilat kanë qënë gjurmët që ju keni lënë në krye të kësaj shoqate? Përgjigje: Nuk do të ishte medeste të flas për punën time si kryetar i kësaj Shoqate për 8 vjet. Bashkë me shokët e kryesisë, ku dhe ju jeni anëtar, jemi përpjekur t’i kryejmë detyrat tona edhe pa mundësi financiare dhe pa seli. Ministria e Kulturës e të dy krahëve të politikës ka qënë shurdhe ndaj kërkesave tona për gjallërimin e veprimtarisë sonë dhe përkrahjen e nxitjen e

letërsisë për fëmijë e të rinj. Pyetje: Cilat janë veprat e tua letrare? Përgjigje: Kam botuar 11 libra me poezi, 8 me prozë dhe mbi 30 me poezi e prozë për fëmijë. Por mendoj se shifrat në art nuk janë tregues i vlerave. Ka shkrimtar si Migjeni që me një libër ka mbetur në historinë e letërsisë shqipe. Unë kam shkruar relativisht pak, po në jetëgjatësinë time nuk e kam lëshuar penën nga dora edhe si redaktor për mbi 50 vjet në shtëpinë botuese “Naim Frashëri”, në Kuvendin e Republikës, për revista shkencore etj. Pyetje: Keni një libër që e mbani më për zemër? Pse? Përgjigje: Libri me poezi “Epidemi kozmike” (1996). Ndoshta ngaqë ishte libri im i parë kur u liruam nga dogmat e realizmit socialist dhe nga zhgënjimi i asaj periudhe kur po i shkruaja ato poezi. “Kohët e reja kanë nevojë për stile të reja” ka thënë shkrimtari Robert Musil. Pyetje: Po të ishit ju deputet i Kuvendit të Republikës, çfarë projektligji do të përpilonit e miratonit për të mbështetur letërsinë e artet? Përgjigje: Është miratuar në vitet ’90 një ligj për sponsorizimin nga ana e privatëve të veprimtarive letrare dhe artistike, por nuk funksionoi, se organet e pushtetit nuk nxorën aktet nënligjore përkatëse. Pyetje: Bibliotekat e qyteteve tona nuk furnizohen rregullisht me librin e ri. Çfarë propozoni ju që libri të shkojë deri në bibliotekën e qytetit

të fundit të Shqipërisë? Përgjigje: Po, ky është problem, por më shqetësues është fakti që mungon interesimi i Ministrisë së Arsimit dhe i qendrave arsimore të bashkive për të vajtur libri edhe në bibliotekat e shkollave të fshatrave më të largëta. Kur flasim e shkruajmë për librin, kemi parasysh njerëzit tanë të së ardhmes - me apo pa kulturë. Pyetje: Ç'mendim keni për konkurset letrare? A ka subjektivizëm te ne në dhënien e çmimeve dhe si mund të përsoset procedura e dhënies së çmimeve? Përgjigje: Natyrisht që ka. Nuk mund t'i shmangesh plotësisht subjektivizmit, se kemi të bëjmë me artin, me shijet e ndryshme, por mund ta minimizosh, duke zgjedhur anëtarë jurie të ndershëm, me përvojë, profesionalizëm e integritet. Pyetje: Nëse Pandeli Koçit do t'i binte "Telebingoja", sa libra njëherësh do të botonte? A keni libra gati për botim dhe nuk keni financë për t'i botuar? Përgjigje: Unë nuk mbaj mend të kem blerë bileta llotarie ose të shkoj të luaj në lodrat e fatit. Nuk kam dashur të fitoj para pa punuar, pa derdhur djersë. Kam gati disa libra, por për një pensionist është e vështirë të përballojë botimin pa sponsorizim dhe shtëpitë botuese kanë përparësi të natyrshme fitimin. Gjithsesi, vazhdoj të shkruaj e të lexoj...

Gary Snyder

JANË DO NJERËZ QË U PËLQEN TË FËLLIQEN FËLLIQEN

Janë do njerëz që u pëlqen të fëlliqen dhe t'i ndreqin gjërat.


Pijnë kafe në agim, birrë pas pune,

Dhe janë do njerëz që mbesin të dëlirtë,
thjesht i vlerësojnë gjërat,

Në mëngjes pinë qumësht dhe lëng në mbrëmje.

Janë do njerëz që i bëjnë të dyja, ata pinë çaj.

Përktheu: Fadil Bajraj




PO NUK E BESONI, FTONI SA MË SHUMË MIQ NË DARKËN E VITIT TË RI


Babai më thoshte gjithmonë që për të kuptuar se cili është një mik i/e mirë, duhet organizuar një festë; me birra, verë e ushqim të mirë, muzikë të bukur në sfond por jo me volum të lartë, që të mund të dëgjoni bisedat mes jush. Fto miq më thoshte, fto shumë miq. Ftoji të gjithë miqtë që njeh, e pastaj kur festa të mbarojë, lër që secili të marrë rrugën që dëshiron, mos detyro asnjë që të qëndrojë. Mos e zgjat asnjëherë më tepër seç duhet festën. Përshëndeti dhe uroji natën e mirë të gjithëve. Dhe vër re se cilët me dëshirë do të qëndrojnë të të ndihmojnë të lash pjatat, të të ndihmojnë të sistemosh shtëpinë. Këta janë miqtë e mirë, që do të të gjenden pranë, kur muzika dhe vera të mbarojë. Miqtë e mirë, janë ata që do të të qëndrojnë edhe kur jeta do të të ofrojë veç thërime e rrëmujë. E në fund të gjithçkaje, më thoshte babai: “mbaj mend se në fund të çdo feste të bukur, në fund të çdo momenti epik, në fund të çdo suksesti të madh, do të shohësh se pranë teje do të qëndrojnë fare pak njerëz, por ata njerëz vlejnë më shumë se gjithçka.”

Përgatiti: Diana Fetahu




Karikatura të karikaturistit bullgar, Lubomir Mihaillov





СНГ/А409/SITUATION CSD 1/5 J. Lennikov, 2002





Lubomir Mihailov në zyrën e kryetarit të komunës në Ferizaj

Всем празднич!




С. Смирнов

— Мистър Путин, лулата на Сталин още дими! :>




ЛЮБОМИР МИХАЙЛОВ



Л. Михайлов. 82

КУЧЕТО КОЕТО...

Gëzuar Vitin e Ri 2026



NISËT KEQ E DEL MIRË

- Deshta me t'vetë dishka Asllan! Zgjedhjet janë ni herë n'katër vjet, a katër herë n'vjet?
- Ni herë n'katër vjet o Xhymë, po nipi jem që e studjon matematikën, m'tha se paska mun'si me rrutllu përmys secilin sen që e shum'zon me minus një. Unë matematikën nuk e di, po asht tu m'u dokë puna pak p'shtjell't.
- Domethanë, kur janë puntë mirë, me shum'zu me minus një, po u bajka llugë a?
- Ashtu po thojke matematika, Xhymë.
- Keq bre!
- Hajt, se nida jm kanë thanë, niset keq e del mirë!


100 EURO PËR ME BA MA SHUMË PARE

- A thu Asllan, pse qeveria po na i ep ka 100 euro, kur ministri i kësaj qeverie po thotë, se populli kurrë nuk ka pasë ma shumë pare?
- Qeveria nuk po na ep pare që jemi fukara, po për me ba ma shumë pare!
- Aaaaa, qekjo nuk m'paska shku n'menë!

GJITHË KY POPULL, PA SAHAT

- Baba Asllan, k'tyne here kishi pas punu shumë e kishi pas fitu pak. Tash na i kemi rregullu puntë kogja mirë.
- Qysh i rregullutë puntë? Tu nejtë n'internet a?
- Nuk ka ran'si ku rrimë, po k'qyri qytetet qysh i kemi ndërtu. Hi n'to e nuk di me dalë.
- Eh! Qetu ke folë drejt. Ju edhe me ditë me dalë, nuk dini kah me ja majtë, se ju hupë busulla. Përpara secili qytet ka pasë sahatkullë edhe e ditshim kohën, patëm s'patëm sahat. Tash k'to ma nuk janë. Kur ka pasë sahat, ka pasë ren, e tash gjithë ky popull, lee që e hupë udhën, po tej t'bje terri, nuk e merr vesh që erdh nata!

I.M.



Për çdo vit të ri, lindin shpresa të reja
dhe në fund sërish zhgënjehemi.

Pastaj vie edhe një Vit i Ri me
shpresa të reja, e një vit tjetër, e një
vit tjetër, ...

Shpresa, shpresa, shpresa,

Shpresa vdes e fundit , thuhet, por si
duket, shpresa nuk vdes kurrë.

Gëzuar Vitin e ri 2026



(Në karikaturë është Distria Krasniqi, karateiste, karikaturuar nga Fatmir Buqa, Kosovë)

Meshkujve nuk u ka mbetur më vend në sportet luftarake. Për të mos rënë nga skena, duhet ta mendojnë një sport tjetër!

DHURATA E KËSULËKUQES

Kësulëkuqia hapi pa gdhirë derën e shtëpisë Dhe pa në oborr mes bukurisë Të borës, Një kalë gjigand prej druri, Si Kali i Trojës. Nëna!... Nëna!... Dil e shiko jashtë Se çfarë dhuratë, Na paska sjellë sivjet Baba Viti! Dhe më nuk priti: Filloi ta tërhiqte pas kapistre ta fuste brenda. Por gjyshja diç i pëshpërit në vesh Dhe një zjarr të madh poshtë barkut të kalit, Shpejt e shpejt ndez. “Buuu”!... ia bëri menjëherë flaka Dhe ç’të shikoje!... Nga bytha e kalit prapa, Sikur po luante “hapa – dollapa” Ujkun e zi, që doli nga barku i tij, Me sytë e kuq nga tymi si thëngjij Dhe bishtin që i kishte marrë flakë, Tek iku me vrap duke sharë: Plakë, moj plakë një ditë ke për të vdekur... Dhe ke për ta parë!... Unë do ta ha Kësulëkuqen, kur të mos jesh ti Në një zjarr të madh si ky, të pjekur! Nëna! Po, si e dallove ujkun futur te kali brënda? Ti nuk shikon nga sytë mirë. Sheh mendja e jo syri, moj bijë! Dhe unë sapo pashë Kalin e Trojës, Mu kujtua një histori që e kisha lexuar Dhe po më binte erë egërsirë.



Karikatura: Aleksander Dubovsky, Ukrainë